



UDHËZUES

Zhvillimi i Konkursit Kombëtar të

Gjuhës Shqipe

me nxënësit e klasave të nënta të arsimit parauniversitar



2026

Udhëzuesi për zhvillimin e Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe me nxënësit e klasave të nënta është hartuar nga grupi i punës, i përbërë nga specialistë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe mësues të gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar. Udhëzuesi është konsultuar dhe është përmirësuar me kontributin e grupit qendror për organizimin e konkursit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit (MA), me qëllim garantimin e cilësisë, koherencës dhe përputhshmërisë së tij me kuadrin ligjor në fuqi.

Hartimi i udhëzuesit është realizuar në përputhje dhe në zbatim të urdhrit të Ministrisë së Arsimit nr. 570, datë 07.11.2025, *“Për organizimin e konkursit kombëtar të gjuhës shqipe me nxënësit e klasave të nënta në arsimin parauniversitar, për vitin shkollor 2025–2026”*, si dhe në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

Koordinimi i procesit të hartimit të udhëzuesit është realizuar nga Erida Koleci, ASCAP

SHKURTESAT

MA	Ministria e Arsimit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
AML	Arsimi i Mesëm i Lartë
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulët
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
KKAP	Korniza Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	6
GJUHA SHQIPE SI PËRPARËSI NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR.....	7
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KONKURSIT	8
QËLLIMI DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT	9
TEMAT NDËRKURRIKULARE NË KONKURSIN KOMBËTAR TË GJUHËS SHQIPE	10
ORGANIZIMI I KONKURSIT.....	12
PROGRAMI ORIENTUES I KONKURSIT	16
RUBRIKAT E KONKURSIT DHE PIKËT PËR ÇDO RUBRIKË	25
PËRSHKRIMI I RUBRIKAVE TË KONKURSIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT	26
1. Kartolina e librit.....	26
2. Pyetje shpejtësie (Kuiz).....	34
3. Recitimi	37
4. Debati në konkurs	41
5. Lojërat gjuhësore	46
6. Projekti.....	47
ÇMIMET NË KONKURSIN KOMBËTAR TË GJUHËS SHQIPE.....	55
SKUADRAT E SHKOLLAVE DHE RREGULLAT E KONKURSIT	55
1. Përbërja e skuadrave të shkollave në konkurs	55
2. Rregullat kryesore për nxënësit në konkurs.....	56
3. Rregullat në lidhje me lëvizjen e nxënësve gjatë konkurrimit në nivel kombëtar	57
ROLI I SHKOLLAVE.....	58
1. Roli i drejtorive të shkollave	58
2. Roli i mësuesit/mësuesve të gjuhës shqipe.....	59
ROLI I DRAP- ve DHE I ZVAP-ve	60

SHTOJCAT	62
Shtojca 1: Procesverbal i jurisë	62
Shtojca 2: Miratimi i prindit/kujdestarit	63
Shtojca 3: Lista emërore e nxënësve për transport	64
BIBLIOGRAFIA	65

HYRJJE

Gjuha shqipe është më shumë se një mjet komunikimi: ajo është pasuri e çmuar, trashëgimi, identitet dhe një urë që lidh brezat me kulturën dhe historinë tonë kombëtare. Nëpërmjet saj përcillen vlera, formësohet mendimi dhe ndërtohet mënyra se si individët komunikojnë dhe bashkëveprojnë në shoqëri. Ruajtja dhe zhvillimi i kësaj pasurie bëhen gjithnjë e më sfiduese në ditët e sotme, kur komunikimi në hapësirën digjitale po zë një vend të rëndësishëm në jetën e të rinjve. Shpejtësia e informacionit, format e reja të shprehjes dhe ndërveprimi i vazhdueshëm në rrjet kërkojnë që nxënësit të pajisen jo vetëm me kompetenca gjuhësore të qëndrueshme, por edhe me aftësi për përdorimin e ndërgjegjshëm dhe etik të gjuhës. Në këtë kontekst, bota e internetit dikton nevojën për edukimin e nxënësve tanë jo vetëm për ta përdorur qartë, saktë dhe bukur gjuhën shqipe, por edhe për të ndërtuar një komunikim të përgjegjshëm, me respekt dhe të vetëdijshëm, si në hapësirën digjitale ashtu edhe në jetën reale. Pikërisht këtij synimi i bashkohet edhe Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe, i cili përbën një mundësi, ku nxënësit shprehin talentin, kompetencat dhe pasionin e tyre për gjuhën shqipe, duke përfitur një përvojë të vlefshme për zhvillimin e tyre, e cila:

- pasuron dhe thellon njohuritë dhe aftësitë gjuhësore të nxënësve për të komunikuar qartë, saktë dhe me argumente në gjuhën shqipe;
- zhvillon aftësitë e të menduarit kritik, përmes analizës dhe vlerësimit të mënyrës së përdorimit të gjuhës në situata të ndryshme komunikimi;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke i udhëhequr nxënësit drejt shprehjes së lirë dhe origjinale të mendimeve dhe ideve të tyre;
- edukon përdorimin e përgjegjshëm të gjuhës në mjediset digjitale, duke lidhur të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit me mjetet e komunikimit bashkëkohor;
- i ndërgjegjëson nxënësit për peshën e fjalës së thënë dhe të shkruar, si në jetën e përditshme ashtu edhe në mjediset digjitale;
- zhvillon iniciativën dhe aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur probleme, përmes përdorimit të gjuhës në situata konkrete që lidhen me jetën shkollore dhe me komunitetin;

- orienton përdorimin e gjuhës për shprehjen e qëndrimeve dhe përçimin e mesazheve pozitive, duke shmangur përdorimin e gjuhës fyese, përjashtuese ose nxitëse të dhunës.

Në konkursin kombëtar të gjuhës shqipe marrin pjesë nxënësit e klasave të nënta të shkollave *publike* dhe *private* në arsimin parauniversitar. Konkursi zhvillohet gjatë periudhës janar-prill 2026 dhe organizohet nga Ministria e Arsimit (MA), me mbështetjen e institucioneve dhe organizatave partnere, si dhe në bashkëpunim me Radio Televizionin Shqiptar (RTSH).

GJUHA SHQIPE SI PËRPARËSI NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Gjuha shqipe (si pjesë përbërëse e formimit gjuhësor, qytetar dhe kombëtar të nxënësve), ka qenë dhe mbetet një përparësi në politikat e Ministrisë së Arsimit. Kjo është pasqyruar edhe në veprimtaritë e zhvilluara vitet e fundit në nivel kombëtar, të cilat lidhen me politikat për promovimin e gjuhës shqipe dhe me bashkëpunimin ndërinstitucional për hartimin, zbatimin dhe komunikimin publik të nismave në fushën e gjuhës shqipe, si edhe me orientimin e përdorimit të saj në përputhje me zhvillimet shoqërore dhe digjitale.

Në këtë kuadër, viti 2024 u shpall Viti i Gjuhës Shqipe. Gjatë këtij viti, në institucionet arsimore u zhvilluan veprimtari të shumta, të cilat synuan promovimin dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore të nxënësve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për vlerën e gjuhës shqipe në jetën shkollore dhe shoqërore.

Po ashtu, u organizua Kuvendi i Gjuhës Shqipe, si një hapësirë bashkëbisedimi dhe reflektimi, ku u trajtuan çështje që lidhen me ruajtjen, pasurimin dhe përdorimin e shqipes në kontekste bashkëkohore, përfshirë ndikimin e komunikimit digjital në mënyrën e të shprehurit.

Në të njëjtën frymë, zhvillimi i Olimpiadës së Përbashkët Shqipëri–Kosovë në lëndën e gjuhës shqipe për klasat e nënta përbën një tjetër nismë me rëndësi, e cila vlerëson njohuritë dhe aftësitë individuale gjuhësore të nxënësve dhe krijon mundësi për vlerësimin e arritjeve të tyre në nivel kombëtar (Kosovë dhe Shqipëri).

Gjatë vitit 2025 ka nisur përditësimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar, i cili solli një ristrukturim më të qartë dhe bashkëkohor të kompetencave kyç dhe një orientim më funksional të procesit të të nxënës. Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar (KKAP), të përditësuar, kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare është trajtuar si kompetencë kyç, e lidhur me përdorimin e gjuhës në situata të ndryshme komunikimi, përfshirë edhe mjediset digjitale. Në këtë kuadër, kurrikulat e gjuhës shqipe dhe të letërsisë po përditësohen për të reflektuar risitë e KKAP-së, për të forcuar koherencën mes niveleve arsimore dhe lëndëve, si dhe për të integruar qasje dhe praktika të përzgjedhura nga përvojat evropiane në lëndët e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, duke ruajtur identitetin dhe veçoritë e tyre.

Ndërkohë, konkursi i gjuhës shqipe me nxënësit e klasave të nënta është konsoliduar si një praktikë e përvitshme që synon evidentimin dhe vlerësimin e aftësive gjuhësore, si dhe krijimin e një hapësire konkurruese ku nxënësit shfaqin talentin dhe nivelin e tyre të përvetësimit dhe të përdorimit të gjuhës shqipe.

Përveç vlerësimit të njohurive dhe të aftësive gjuhësore, konkursi i këtij viti synon të nxisë reflektimin mbi rolin e gjuhës shqipe në ndërtimin e komunikimit të shëndetshëm dhe të marrëdhënieve të bazuara në mirëkuptim dhe respekt. Në këtë kuadër, konkursi vendos theksin te përdorimi i gjuhës për shprehjen e mendimeve dhe të qëndrimeve në mënyrë të kujdesshme, të saktë dhe të përgjegjshme, përmes trajtimit të situatave që lidhen me jetën shkollore dhe komunitare, përfshirë edhe në hapësirën digjitale. Kështu, njohuritë dhe aftësitë gjuhësore trajtohen jo vetëm si objekt konkurrimi dhe vlerësimi, por edhe si mjet për dialog dhe qartësim qëndrimesh, duke nxitur përgjegjësi për fjalën dhe mënyrën e përdorimit e saj në komunikim.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KONKURSIT

Qëllimi i Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe është vlerësimi, evidentimi dhe promovimi i arritjeve gjuhësore të nxënësve. Konkursi vendos në qendër përdorimin e gjuhës shqipe me cilësi, përgjegjësi dhe vetëdije, si mjet shprehjeje, mendimi dhe komunikimi në kontekste të ndryshme, si dhe nxjerr në pah rolin e saj të rëndësishëm në formimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve.

Objektivat e konkursit janë:

- të evidentojë përdorimin e gjuhës shqipe në mënyrë të saktë, të qartë dhe funksionale në tema dhe situata të ndryshme komunikimi;
- të nxjerrë në pah aftësinë e nxënësve për të ndërtuar dhe shprehur mendime dhe qëndrime të arsyetuara në debate dhe diskutime të ndryshme;
- të identifikojë, të zhvillojë dhe të vlerësojë talentin gjuhësor të nxënësve në forma të ndryshme shprehjeje, si shkrimi, recitimi, prezantimi, interpretimi etj.
- të vlerësojë mënyrën se si nxënësit kuptojnë, analizojnë, interpretojnë dhe vlerësojnë tekste letrare dhe joletrare, duke dalluar veçori përmbajtjesore, gjuhësore, stilistike dhe shprehëse;
- të evidentojë përdorimin e vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm të gjuhës shqipe në situata që lidhen me jetën shkollë, komunitare dhe komunikimin bashkëkohor;
- të sigurojë kushte për garim të ndershëm, ku talenti ose arritja gjuhësore të jetë kriteri kryesor i vlerësimit;
- të nxisë interesin dhe vlerësimin për gjuhën shqipe si shprehje e identitetit kombëtar dhe për letërsinë si pasuri kulturore shqiptare dhe botërore.

QËLLIMI DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT

Udhëzuesi për zhvillimin e Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe (më poshtë konkursi), me nxënësit e klasave të nënta në arsimin parauniversitar, ka për qëllim:

- të orientojë mësuesit e gjuhës shqipe dhe drejtuesit e institucioneve arsimore në përgatitjen dhe përfshirjen e nxënësve në të gjitha fazat e konkursit;
- të mbështesë përfaqësuesit dhe specialistët e DRAP-ve dhe ZVAP-ve në organizimin, zhvillimin dhe monitorimin e konkursit në të gjitha fazat e tij;
- të garantojë një proces të unifikuar, transparent dhe të drejtë në zbatimin e konkursit në nivel shkolle, ZVAP/DRAP dhe kombëtar.

Në udhëzues janë trajtuar çështjet e mëposhtme:

- Organizimi i konkursit dhe fazat e zhvillimit të tij, me sqarimin e procedurave të konkurrimit për do fazë.

- Programi orientues i konkursit, ku paraqiten njohuritë dhe aftësitë gjuhësore dhe letrare që vlerësohen gjatë të gjitha fazave.
- Rubrikat e konkursit dhe shpërndarja e pikëve për secilën rubrikë.
- Përshkrimi i rubrikave dhe kriteret përkatëse të vlerësimit.
- Përbërja e skuadrave të shkollave dhe rregullat e zhvillimit të konkursit.
- Çmimet në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe.
- Roli dhe përgjegjësitë e drejtuesve të shkollave dhe të mësuesve të gjuhës shqipe.
- Roli dhe përgjegjësitë e DRAP-ve dhe ZVAP-ve në organizimin dhe mbarëvajtjen e konkursit.

TEMAT NDËRKURRIKULARE NË KONKURSIN KOMBËTAR TË GJUHËS SHQIPE

Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe ka në qendër vlerësimin e njohurive dhe të aftësive gjuhësore e letrare të nxënësve, megjithatë në përmbajtjen e rubrikave të tij, gjuha shqipe nuk trajtohet në mënyrë të izoluar, por vihet në funksion të situatave reale të komunikimit dhe të problematikave që karakterizojnë shoqërinë bashkëkohore, specifikisht grup-moshën e nxënësve. Kjo qasje reflekton synimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, sipas së cilës të nxënësve të gjuhës lidhet drejtpërdrejt me realitetin shoqëror, kulturor dhe qytetar.

Temat ndërkurrikulare në AMU janë:



Në këtë kuadër, rubrikat e konkursit mund të përfshijnë tema dhe situata komunikimi që lidhen me identitetin kombëtar, qytetarinë dhe sipërmarrjen, shëndetin dhe sigurinë, zhvillimin e qëndrueshëm, teknologjinë dhe median. Këto tema shërbejnë si kontekste ku nxënësit demonstrojnë aftësinë për të përdorur gjuhën shqipe në mënyrë

të saktë, të qartë dhe funksionale, për të ndërtuar mendime dhe qëndrime të arsyetuar, si dhe për të interpretuar dhe analizuar tekste të ndryshme.

Përfshirja e temave ndërkurrikulare synon të pasqyrojë faktin se gjuha shqipe është mjet themelor për të kuptuar botën, për të ndërtuar marrëdhënie shoqërore dhe për të marrë pjesë aktive në jetën e komunitetit. Përmes trajtimit të këtyre çështjeve, nxënësit vendosen përballë situatave ku kërkohet përdorim i kujdesshëm i gjuhës, qartësi shprehjeje, respekt për mendimin e tjetrit dhe përgjegjësi për fjalën e thënë dhe të shkruar.

Këto tema nuk përbëjnë objekt vlerësimi më vete dhe nuk zëvendësojnë përmbajtjet gjuhësore dhe letrare të konkursit. Ato shërbejnë si kuadër për vlerësimin e kompetencave gjuhësore, duke i dhënë kuptim përdorimit të gjuhës shqipe në kontekste konkrete dhe duke nxitur lidhjen e saj me realitetet e jetës shkollore, shoqërore dhe kulturore.

Në këtë mënyrë, konkursi ruan fokusin e tij kryesor te gjuha shqipe dhe letërsia, duke i vendosur ato në dialog të natyrshëm me temat dhe sfidat e kohës, si dhe duke u dhënë nxënësve mundësinë të shfaqin jo vetëm kompetencat gjuhësore, por edhe aftësinë për të komunikuar me vetëdije dhe përgjegjësi në situata të ndryshme.

Shembuj:


- ✓ ***Në rubrikën e pyetjeve mbi librin,*** temat ndërkurrikulare pasqyrohen përmes trajtimit të ngjarjeve, personazheve dhe marrëdhënieve që lidhen me identitetin kombëtar, përgjegjësinë individuale dhe kolektive, bashkëjetesën, empatinë, pranimin e diversitetit, gjithëpërfshirjen etj. Në këtë kuadër, nxënësit përdorin gjuhën shqipe për të kuptuar, interpretuar dhe shprehur qëndrime mbi tekstin..
- ✓ ***Në rubrikën e recitimit,*** për zgjedhja dhe interpretimi i teksteve letrare lidhet me shprehjen e ndjenjave, vlerave dhe përvojave njerëzore që kanë lidhje me identitetin kombëtar, kujtesën, dashurinë dhe mirëkuptimin mes njerëzve etj.
- ✓ ***Në rubrikën e debatit,*** temat ndërkurrikulare shfaqen përmes diskutimit të çështjeve që lidhen me jetën shkollore dhe shoqërore, qytetarinë, komunikimin bashkëkohor, teknologjinë dhe marrëdhëniet mes individëve. Në këtë rubrikë, gjuha shqipe përdoret si mjet për ndërtimin e argumentit, shprehjen e qëndrimeve dhe respektimin e rregullave të dialogut dhe komunikimit të kujdesshëm.

- ✓ *Në rubrikën e projektit*, temat ndërkurrikulare shërbejnë si bazë për trajtimin e problematikave që lidhen me komunitetin, zhvillimin e qëndrueshëm, teknologjinë, median, jetën shoqërore etj. Gjuha shqipe vlerësohet në funksion të organizimit të mendimit, qartësisë së prezantimit, koherencës së tekstit dhe aftësisë për të përçuar ide dhe qëndrime në mënyrë të strukturuar.

ORGANIZIMI I KONKURSIT

Konkursi synon të identifikojë dhe të promovojë talentet gjuhësore dhe letrare të nxënësve, duke i përfshirë ata në një garë me disa faza dhe rubrika të larmishme. Në të tria fazat e konkursit ndiqen rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara në “Rubrikat e konkursit dhe pikët për çdo rubrikë”.

Konkursi zhvillohet në tri faza. Skema e organizimit dhe e zhvillimit të konkursit është përcaktuar nga grupi qendror i ngritur nga Ministria e Arsimit, në urdhrin nr. 570, datë 07.11.2025, “Për organizimin e konkursit kombëtar të gjuhës shqipe me nxënësit e klasave të nënta në arsimin parauniversitar, për vitin shkollor 2025–2026”.



FAZA 1: Organizimi i konkursit në nivel shkolle

Në këtë fazë:

- Konkursi zhvillohet mes klasave të nënta në çdo shkollë. Nëpërmjet kësaj gare identifikohen nxënësit që shfaqin talent ose aftësi të spikatura gjuhësore.
- Në rastet kur shkolla ka vetëm një (1) klasë të nëntë, konkursi zhvillohet brenda klasës, ndërmjet nxënësve të saj, sipas të njëjtave rubrika dhe procedura vlerësimi. Në të dyja rastet, qëllimi i fazës në nivel shkolle është identifikimi i nxënësve që do të përbëjnë skuadrën përfaqësuese të shkollës për fazat pasuese të konkursit.
- Pyetjet e konkursit në këtë fazë hartohen nga mësuesit e gjuhës shqipe të shkollës, në përputhje me rubrikat e konkursit dhe me programin orientues.

- Juria në nivel shkolle mund të përbëhet nga mësues të gjuhës shqipe dhe, sipas mundësive, nga drejtues të institucionit arsimor, mësues të gjuhëve të huaja, ish-mësues të gjuhës shqipe, prindër, profesionet e të cilëve lidhen me gjuhën shqipe dhe letërsinë. Juria ngrihet me urdhër të drejtorit të shkollës.
- Mësuesi/t e gjuhës shqipe, bazuar në talentin dhe rezultatet e nxënësve gjatë konkursit, përzgjedhin nxënësit që do të jenë pjesë e skuadrës përfaqësuese të shkollës.
- Përzgjedhja bëhet edhe duke marrë në konsideratë rubrikat e konkursit: pra një nxënës që spikat në recitim ose interpretim, një nxënës që ka talent për të krijuar, një nxënës që ka aftësi në hartimin dhe prezantimin e projekteve, një nxënës që ka njohuri dhe aftësi për të diskutuar ose debatuar etj.
- Drejtori i shkollës cakton një ose më shumë mësues, kryesisht të gjuhës shqipe, të cilët ngarkohen me përgatitjen e skuadrës përfaqësuese të shkollës për fazat pasuese të konkursit. Këta mësues mbështesin nxënësit në përgatitjen e projektit, të debatit dhe të rubrikave të tjera të konkursit.
- Zhvillimi i konkursit në këtë fazë monitorohet nga ZVAP, me qëllim garantimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzues.

FAZA 2: Organizimi i konkursit në nivel ZVAP-je dhe në nivel DRAP-i

Në këtë fazë, konkursi zhvillohet në nivel vendor, nën koordinimin e ZVAP-ve dhe me përfshirjen e DRAP-ve përkatëse.

a) Konkursi në nivel ZVAP-je


- Skuadrat përfaqësuese të shkollave që i përkasin të njëjtës ZVAP, marrin pjesë në konkurs dhe konkurrojnë me njëra-tjetrën sipas renditjes së përcaktuar me short nga ZVAP.
- Konkursi zhvillohet në përputhje me rubrikat dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzues.
- Pyetjet e konkursit në këtë fazë hartohen nga një grup pune i ngritur pranë ZVAP-së, me përfshirjen e mësuesve të gjuhës shqipe dhe specialistëve përkatës, në përputhje me programin orientues dhe me rubrikat e konkursit.

- Në përfundim të konkurseve në nivel ZVAP-je, çdo ZVAP shpall një (1) skuadër fituese shkollë.
- Skuadra fituese përfaqëson ZVAP-në përkatëse në fazat pasuese të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe.
- Juria e konkursit në nivel ZVAP-je përbëhet nga mësues të gjuhës shqipe dhe specialistë të fushës, të caktuar nga ZVAP-ja, sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzues. Në përbërje të jurisë së konkursit në këtë fazë përfshihet një përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), me qëllim garantimin e një vlerësimi të unifikuar dhe transparent të skuadrave pjesëmarrëse në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe.
- Zhvillimi i konkursit në këtë fazë monitorohet nga DRAP, me qëllim garantimin e zbatimit të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzues.



a) Renditja në nivel DRAP-i

- Skuadrat fituese, përfaqësuese të çdo ZVAP-je, renditen sipas pikëve nga DRAP-i përkatës.
- Në këtë fazë nuk zhvillohet konkurrim i drejtpërdrejtë ndërmjet skuadrave, por kryesisht bëhet vetëm renditja e tyre sipas pikëve.
- Çdo DRAP, në përputhje me renditjen e pikëve, për zgjedh katër (4) skuadra me rezultatin më të lartë për t'i kualifikuar në fazën kombëtare të konkursit.



- Në rast pikësh të barabarta në nivel ZVAP-je, DRAP-i për zgjedh shkollën/skuadrën që ka më shumë pikë në vlerësimin e projektit. Nëse barazimi

vazhdon edhe pas vlerësimit të projektit, atëherë do të merret në konsideratë renditja në rubrikën e debatit në konkurs.


- Në rast se më shumë se katër (4) skuadra rezultojnë me numrin maksimal të pikëve, DRAP-i kryen një vlerësim shtesë të rubrikës së projektit për këto skuadra dhe mbi këtë bazë, përcakton katër (4) skuadrat fituese. Vlerësimi i projektit realizohet sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzuesin e konkursit. Ky vlerësim bëhet nga një juri e posaçme, e përbërë nga:
 - ✓ 2 mësues të gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të lartë (AML), me përvojë në vlerësimin e projekteve;
 - ✓ 1 specialist i fushës pranë DRAP-it.
- Vlerësimi i projektit kryhet nga tre (3) anëtarët e jurisë, të cilët japin vlerësim individual, sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzues. Pikët përfundimtare të projektit përlllogariten si mesatare aritmetike e pikëve të dhëna nga anëtarët e jurisë dhe shërbejnë si bazë për renditjen e skuadrave.
- Në përfundim të kësaj faze, nga 5 (pesë) DRAP-et kualifikohen gjithsej 20 (njëzet) skuadra për pjesëmarrje në konkurs, në nivel kombëtar.

DRAP Durrës				DRAP Fier				DRAP Korçë				DRAP Lezhë				DRAP Tiranë			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20

Faza 3: Organizimi i konkursit në nivel kombëtar

- Në këtë fazë marrin pjesë 20 skuadra, përfaqësuese të DRAP-eve, të cilat konkurrojnë dy nga dy me njëra-tjetrën.
- Çiftëzimi i skuadrave për konkurrim përcaktohet me short, i cili hidhet në mënyrë transparente online në mjediset e Ministria e Arsimit.
- Pyetjet e konkursit në nivel kombëtar hartohen nga një grup pune i ngritur në ASCAP, në përputhje me programin orientues dhe me rubrikat e konkursit.
- Konkurrimi zhvillohet në dhjetë (10) episode, secili me një përballje mes dy skuadrave.
- Pas përfundimit të dhjetë (10) episodeve, bëhet renditja e përgjithshme e skuadrave, bazuar në pikët e grumbulluara.

- Dy (2) skuadrat me numrin më të lartë të pikëve kualifikohen për në finalen e konkursit kombëtar të gjuhës shqipe.
- Në rast barazimi pikësh mes skuadrave që synojnë kualifikimin në finale, përparësi i jepet skuadrës që ka më shumë pikë në rubrikën e projektit. Nëse barazimi vijon edhe pas këtij kriteri, merret në konsideratë renditja në rubrikën e debatit të konkursit.
- Në total, njëmbëdhjetë (11) episode të konkursit xhirohen dhe transmetohen në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH).



Shkollat njoftohen për datat e konkurseve të çdo episodi nga AKAP, DRAP-et dhe ZVAP-të përkatëse.

Juria e konkursit në nivel kombëtar

- Juria e konkursit në nivel kombëtar përbëhet nga specialistë të fushës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, mësues me përvojë në konkurse kombëtare, si dhe përfaqësues të institucioneve përgjegjëse në fushën e arsimit.
- Anëtarët e jurisë së konkursit në nivel kombëtar janë njohës të arsimit parauniversitar, të kurrikulës dhe të karakteristikave zhvillimore të grup-moshës së nxënësve të klasave të nënta.
- Anëtarët e jurisë caktohen nga institucionet përgjegjëse dhe nuk duhet të kenë konflikt interesi me skuadrat pjesëmarrëse.

PROGRAMI ORIENTUES I KONKURSIT

Për të orientuar punën e mësuesve dhe përgatitjen e nxënësve për pjesëmarrjen në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe, në udhëzuesin e konkursit është përfshirë programi orientues. Programi synon të sigurojë përgatitje të njëtrajtshme dhe cilësore në të gjitha fazat e konkursit dhe përfshin:

- njohuritë dhe aftësitë kryesore të kurrikulës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët;

- njohuri të përgjithshme për historinë e gjuhës shqipe dhe zhvillimet kryesore që lidhen me të;
- veprat letrare (librat) mbi të cilat hartohen pyetjet e rubrikës së konkursit “Kartolina e librit”.

Në konkursin e këtij viti, pyetjet e rubrikës “Kartolina e librit” në fazën e dytë dhe të tretë të konkursit (në nivel ZVAP-je dhe në nivel kombëtar) do të bazohen në veprat e mëposhtme, leximi i plotë i të cilave është i domosdoshëm për nxënësit:

- ✓ “Histori e Skënderbeut” Naim Frashëri
- ✓ “Djemtë e rrugës Pal” Ferenc Molnar
- ✓ “Princi i vogël” Antoine de Saint Exupery
- ✓ “Tregime të moçme shqiptare” Mitrush Kuteli
- ✓ “Ditari i Ana Frankut” Ana Frank
- ✓ “Shpella e piratëve” Petro Marko
- ✓ “Kronikë në gur” Ismail Kadare

Shënim:

- Duke qenë se faza e konkursit në nivel shkolle zhvillohet në një afat të shkurtër kohor, leximi i plotë i këtyre veprave nga nxënësit planifikohet të përfundojë në fazat e tjera të konkursit, përkatësisht në nivel ZVAP dhe në nivel kombëtar.
- Në nivel shkolle, pyetjet e rubrikës “Kartolina e librit” mund të hartohen mbi tekste ose fragmente letrare të përfshira në tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe në përputhje me programin lëndor.
- Në vitet pasuese, veprat letrare për rubrikën “Kartolina e librit” rinovohen dhe shpallen çdo vit në udhëzuesin përkatës të konkursit.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore të kurrikulës së gjuhës shqipe në AMU

Për secilën kompetencë të kurrikulës së gjuhës shqipe janë paraqitur aftësitë dhe njohuritë që do të vlerësohen gjatë konkursit në të gjitha fazat.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
Njohuritë	Aftësitë
- Prezantimi i një projekti. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe	Nxënësi:

komunikimit në prezantimin e projekteve. - Rregullat e recitimit dhe interpretimit të tekstit letrar. - Rregullat dhe etika e debatit. - Parimet e komunikimit publik dhe të të folurit përpara dëgjuesve. - Elementet stilistike të të folurit (intonacioni, ritmi, theksi). - Roli i gjuhës joverbale në komunikim.	- flet qartë, rrjedhshëm dhe me intonacion të përshtatshëm për situatën e komunikimit; - përzgjedh fjalët në varësi të qëllimit, dëgjuesit dhe temës; - ka fjalor të pasur, përdor shprehje frazeologjike, shprehje të figurshme dhe fjalë të urta gjatë të folurit; - shpreh ndjenja, qëndrime dhe emocione gjatë të folurit, në përputhje me përmbajtjen e mesazhit; - përdor elementet joverbale (gjestet, mimikën dhe gjuhën e trupit) për të mbështetur fjalët e tij; - kontrollon përdorimin e gjesteve gjatë të folurit, në mënyrë që dëgjuesi të mos shmangë vëmendjen nga mesazhi; - përdor gjuhën standarde në situata formale komunikimi; - shmang gjatë të folurit përdorimet pa vend të fjalëve dhe të formave gjuhësore që e dëmtojnë gjuhën shqipe; - përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në mënyrë funksionale gjatë prezantimit të projektit; - ndjek rregullat gjatë diskutimit, prezantimit ose debatit në grup; - ndan rolet gjatë diskutimeve ose gjatë debateve; - bashkëbisedon lirshëm duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, si dhe duke respektuar edhe mendimet dhe gjykimet e të tjerëve;
--	--

	- shpreh mendimet dhe këndvështrimet e tij, duke respektuar edhe faktorin kohë; - pasuron linjën e debatit ose të diskutimit me argumente duke respektuar etikën e komunikimit; - përmbledh informacionin që prezantohet gjatë debateve dhe formulon konkluzione dhe përfundime të arsyetuara.
--	--

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	
Njohuritë	Aftësitë
- Tekstet letrare dhe joletrare. Dallimet kryesore mes tyre. - Tema kryesore dhe motivi/et. - Idetë kryesore dhe informacionet e tekstit. - Struktura, përmbajtja dhe forma e tekstit. - Tekste të ndryshme letrare: tekste poetike dhe tekste në prozë. Tiparet kryesore të tyre. - Gjuha e figurshme. Figurat stilistike: <i>personifikimi, antiteza, krahasimi, hiperbola, metafora, anafora, simboli, alegoria, inversioni</i>. - <i>Teksti poetik:</i> Rima dhe strofat në një tekst poetik. Tiparet kryesore të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik. - <i>Teksti në prozë:</i> Tiparet kryesore të disa teksteve në prozë (përralla, legjenda, fabula, proza poetike, tregimi, novela, romani). Subjekti i një proze. Analiza e personazhit. Rrëfimtari.	Të lexuarit e teksteve letrare Nxënësi: - përcakton qëllimet e teksteve letrare; - analizon veçoritë e letërsisë gojore ose të folklorit; - grupon tekstet që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare; - identifikon veçoritë kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare; - dallon figurat stilistike si: <i>personifikimi, antiteza, krahasimi, hiperbola, metafora, anafora, simboli, alegoria, inversioni</i>; - zbërthen figurat stilistike duke treguar funksionin shprehës të tyre; - kupton, analizon, interpreton dhe vlerëson veprat letrare të përzgjedhura për rubrikën “Kartolina e librit”, duke identifikuar gjininë, tematikën, motivet, subjektin, personazhet, mënyrën e rrëfimit dhe vlerat letrare të tyre, si dhe duke i lidhur me kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor. Teksti poetik

- Tekste letrare orientuese për lexim dhe analizë, të përzgjedhura në funksion të rubrikës së konkursit “Kartolina e librit”: ✓ “Historia e Skënderbeut” Naim Frashëri. ✓ “Djemtë e rrugës Pal” Ferenc Molnár (roman); ✓ “Princi i vogël” Antoine de Saint-Exupéry. ✓ “Ditari i Ana Frankut” Ana Frank. ✓ “Kronikë në gur” Ismail Kadare. ✓ “Tregime të moçme shqiptare” Mitrush Kuteli. ✓ “Shpella e piratëve” Petro Marko. Për veprat e mësipërme: Njohuri mbi gjininë, tematikën, motivet, subjektin, personazhet, mënyrën e rrëfimit, vlerat letrare, aktualizimin dhe lidhjen e veprës me kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor, si edhe mbi njohjen, kuptimin, analizën dhe vlerësimin e veprës letrare. - Tekstet joletrare: përshkrime, rrëfime, kronika, biografi, reportazhe, intervista, ditare, email-e, reklama, fjalime, podcaste, blogje, artikuj online, meme, ese të ndryshme. - Tiparet/ veçoritë kryesore të teksteve jo letrare.	Nxënësi: - përkufizon temën dhe motivin e një teksti; - dallon tiparet kryesore të metrikës në poezi (lloji i rimës dhe i strofës), si dhe shpjegon funksionin e tyre; - dallon vargun e lirë në një poezi dhe shpjegon funksionin e tij; - analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik; - analizon dhe vlerëson tiparet e disa teksteve poetike, si soneti, himni, elegjia etj. Teksti në prozë Nxënësi: - përkufizon dhe analizon veçoritë e teksteve në prozë si: tema, vendi, koha, konteksti, personazhet etj.; - përcakton tiparet kryesore të disa teksteve në prozë, si: përralla, legjenda, fabula, proza poetike, tregimi, novela, romani; - dallon mënyrën e rrëfimit në një tregim, roman etj., si dhe shpjegon funksionin e saj; - dallon rrëfimtarin në një tekst. Të lexuarit e teksteve joletrare Nxënësi: - identifikon dhe analizon qëllimet e teksteve joletrare; - përkufizon dhe analizon veçoritë e teksteve joletrare, si: përshkrime, rrëfime, kronika, biografi, reportazhe, intervista, ditare, email, reklama, fjalime, podcaste, blogje, artikuj online, meme, ese; - dallon faktin nga opinioni;
---	---

	- dallon shkakun nga pasoja në një tekst; - dallon dhe përdor njohuritë rreth elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, citimi, bibliografia; - dallon argumentet <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> një çështjeje dhe i vlerëson ato.
--	--

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
Njohuritë	Aftësitë
- Hartimi dhe prezantimi i një projekti.	Procesi i të shkruarit Nxënësi: - rendit dhe organizon idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme; - respekton strukturën e shkrimit dhe prezantimit të projektit (hyrje, zhvillim dhe mbyllje); - përshtat gjuhën me qëllimin dhe me lexuesin; - përzgjedh fjalët dhe frazat që i japin prezantimit të projektit gjallëri dhe shprehësi; - përdor lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë) për të shtuar interesin e lexuesit dhe për të përmirësuar rrjedhën e punës me shkrim; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit; - zbaton njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - rishikon prezantimin e projektit për të përmirësuar përmbajtjen, organizimin, qartësinë, stilin dhe gjuhën.

Përdorimi i drejtë i gjuhës	
Njohuritë	Aftësitë
Sintaksë - Llojet e fjalive sipas kumtimit. - Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe. Fjalja	Sintaksë Nxënësi: - përcakton llojin e fjalisë sipas kumtimit dhe argumenton përgjigjen e tij;

njëkryegjymtyrëshe foljore. Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore. - Fjalitë e thjeshtë dhe fjalitë e përbërë. - Fjalitë e përbërë me bashkërenditje. - Fjalitë e përbërë me nënrenditje. - Gjymtyrët kryesore (kryefjala dhe kallëzuesi). - Gjymtyrët e dyta (përcaktori, kundrinori, rrethanori, përcaktori kallëzuesor). Llojet. - Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.	- ndërton dhe analizon fjali të ndryshme dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore; - dallon llojin e fjalisë sipas ndërtimit (përbërjes) dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon fjalinë dykryegjymtyrëshe dhe fjalinë njëkryegjymtyrëshe, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon dhe ndërton fjali njëkryegjymtyrëshe foljore dhe emërore, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalitë e përbërë dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton llojin e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - ndërton fjali të ndryshme me bashkërenditje dhe me nënrenditje; - ndërton skemën e një fjalie të përbërë; - dallon funksionet gramatikore të gjymtyrëve (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, përcaktor kallëzuesor, kundrinor, rrethanor) në një fjali të dhënë dhe përcakton se me çfarë shprehen; - përcakton llojet e kundrinorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton llojet e përcaktorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton llojet e rrethanorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor në fjali kundrinorin, përcaktorin, përcaktorin kallëzuesor dhe rrethanorin; - kthen ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjellas.
Morfologji	Morfologji Nxënësi:

- Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme. - Kategoritë gramatikore të emrit. - Kategoritë gramatikore të mbiemrit. - Kategoritë gramatikore të foljes. - Format e pashtjelluara të foljes. Llojet. - Përemrat. Llojet. Kategoritë gramatikore. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara. - Ndajfoljet. Llojet. - Lidhëzat. Llojet. - Parafjalët sipas rasave.	- dallon klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të emrit dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të mbiemrit dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të foljes dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon dhe përdor format e pashtjelluara; - analizon funksionet e formave të pashtjelluara; - përcakton llojin e përemrit dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të përemrit të ndryshëm; - dallon dhe përdor trajtat e shkurtra dhe të bashkuara (tri pozicionet); - gjen ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon lidhëzat dhe përcakton llojin e tyre, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon parafjalët sipas rasave dhe argumenton përgjigjen e tij.
Fjalëformim - Fjala dhe përbërësit e saj. - Fjalët e thjeshta dhe fjalët jo të thjeshta. - Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. - Fjalët e prejardhura. - Fjalët e përbëra. - Fjalët e përngjitura.	Fjalëformim Nxënësi: - analizon përbërësit e fjalës; - dallon fjalët e thjeshta nga fjalët jo të thjeshta dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton mënyrën e formimit të fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon fjalët e prejardhura dhe përcakton llojin e tyre; - formon fjalë të prejardhura; - dallon dhe formon fjalë të përbëra; - dallon dhe përdor në fjali fjalë të përngjitura.
Leksikologji	Leksikologji

- Gjuha standarde shqipe. - Huazimet. - Dialektet e gjuhës shqipe. - Kuptimet e fjalëve. - Kuptimi i figurshëm i fjalëve. - Familja e fjalëve. - Sinonimet dhe antonimet. - Shprehjet frazeologjike. - Fjalët e urta.	Nxënësi: - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit dhe të shkruarit; - dallon fjalët dialektore dhe vlerëson dialektet si pasuri leksikore të gjuhës shqipe; - shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit; - përcakton dhe analizon kuptimet e fjalës; - dallon kuptimin e figurshëm të fjalës; - ndërton familjen e fjalëve të ndryshme, jo më pak se katër fjalë; - krijon çifte sinonimie dhe antonimie; - dallon dhe përdor në fjali fjalët e urta; - dallon dhe përdor në fjali shprehjet frazeologjike.
Histori e gjuhës shqipe - Gjuha shqipe dhe vendi i saj në familjen e gjuhëve indoevropiane. - Dëshmitë, dokumentet e para të shkrimit të shqipes dhe libri i parë në gjuhën shqipe. - Kongresi i Manastirit dhe ai i Elbasanit, vendimet më të rëndësishme të tyre. - Kongresi i Drejtshkrimit.	Histori e gjuhës shqipe Nxënësi: - vlerëson lashtësinë e gjuhës shqipe si pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane; - analizon dhe vlerëson dokumentet e para të shkrimit të shqipes; - analizon dhe vlerëson vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit dhe të Kongresit të Elbasanit; - analizon dhe vlerëson vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Drejtshkrimit.
Drejtshkrim - Përdorimi i shenjave të pikësimit. - Përdorimi i apostrofit. - Drejtshkrimi i shkronjës së madhe. - Drejtshkrimi i përemrave, ndajfoljeve, parafjalëve, numërorëve dhe pjesëzave	Drejtshkrim Nxënësi: - përdor saktë shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor drejt apostrofin dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor saktë shkronjën e madhe dhe argumenton përgjigjen e tij;

sipas rregullave të drejtshkrimit. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në trup dhe në fund të fjalës. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore: <i>sh, zh, ç, s, z</i>. - Drejtshkrimi i zanoreve: <i>e, ë, i/y, u/y</i>. - Drejtshkrimi i fjalëve që përmbajnë grupet e zanoreve: <i>ye, ua, ie</i>. - Drejtshkrimi i fjalëve që mbarojnë me: <i>-ër, -ërr, ël</i> në shumës.	- shkruan saktë përemrat, ndajfoljet, parafjalët, numërorët dhe pjesëzat sipas rregullave të drejtshkrimit, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - shkruan drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës; - përdor saktë bashkëtingëlloret nistore: <i>sh, zh, ç, s, z</i>; - përdor drejt zanoret: <i>e, ë, i/y, u/y</i> në fjalë të ndryshme; - shkruan saktë fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: <i>ye, ua, ie</i>; - shkruan drejt fjalët që mbarojnë me: <i>-ër, -ërr, ël</i> në shumës.
--	---

RUBRIKAT E KONKURSIT DHE PIKËT PËR ÇDO RUBRIKË

Në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe, rubrikat janë konceptuar si komponentë të ndërlidhur që, së bashku, përbëjnë një tërësi funksionale. Filli që i bashkon këto rubrika dhe i jep konkursit idenë e një tërësie është niveli i njohurive dhe aftësive të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe.

Në të tria fazat e konkursit, rubrikat dhe numri i pikëve për secilën rubrikë paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rubrika	Numri i pikëve
1.	Kartolina e librit	14 pikë
2.	Recitimi	8 pikë
3.	Pyetje shpejtësie (<i>Kuiz</i>)	20 pikë
4.	Debati në konkurs	15 pikë
5.	Lojërat gjuhësore	13 pikë
6.	Projekti	30 pikë
Gjithsej		100 pikë

PËRSHKRIMI I RUBRIKAVE TË KONKURSIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT

1. Kartolina e librit

Përzgjedhja e librave

Kjo rubrikë ndërtohet mbi shtatë (7) libra të përzgjedhur për Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe, të cilat përfaqësojnë gjini të ndryshme, autorë shqiptarë dhe të huaj, si dhe tema të përshtatshme për moshën e nxënësve të klasës së nëntë. Këto vepra janë: “Historia e Skënderbeut” e Naim Frashërit, “Djemtë e rrugës Pal” e Ferenc Molnár, “Princi i vogël” i Antoine de Saint-Exupéry, “Ditari i Ana Frankut” i Ana Frank, “Kronikë në gur” i Ismail Kadaresë, “Tregime të moçme shqiptare” i Mitrush Kutelit dhe “Shpella e piratëve” i Petro Markos.

Përfshirja e këtyre veprave bazohet në kriteret letrare e kurrikulare dhe synon:

- të promovojë leximin dhe ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme me librin;
- të zhvillojë aftësitë interpretuese, analitike dhe gjuhësore të nxënësve;
- të sigurojë përputhje me programin mësimor të gjuhës shqipe dhe objektivat e kurrikulës;
- të krijojë një bazë të përbashkët dhe të drejtë vlerësimi për të gjithë nxënësit pjesëmarrës në konkurs.

Në konkurset e viteve të ardhshme, lista do të rinovohet, duke përfshirë libra të tjerë, të cilët shpallen në udhëzuesin përkatës të konkursit, me qëllim promovimin e vazhdueshëm të leximit, pasurimin e përvojës letrare të nxënësve me autorë dhe tema të reja, si dhe shmangien e përsëritjes.

Pyetjet në këtë rubrikë

Në këtë rubrikë përfshihen pyetje të llojeve të ndryshme, të cilat vlerësojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lidhje me veprat letrare të përzgjedhura për rubrikën “Kartolina e librit”. Pyetjet synojnë kryesisht vlerësimin e aftësive të nivelit mesatar dhe të lartë, si: zbatimi, analiza, interpretimi, vlerësimi, gjykimi, mendimi kritik, aktualizimi dhe krijimi.

Pyetjet e kësaj rubrike përqendrohen:

- në njohjen dhe kuptimin e veprës letrare;

- në analizën e elementeve përbërëse të saj (gjini, tematikë, motive, subjekt, personazhe, mënyrë rrëfimi);
- në interpretimin dhe vlerësimin e mesazheve, ideve dhe vlerave letrare;
- në lidhjen e veprës me kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor;
- në aktualizimin e problematikave të veprës në kontekste bashkëkohore.

Llojet kryesore të pyetjeve në këtë rubrikë janë:

Pyetje me përgjigje të shkurtër, të cilat kërkojnë nga nxënësit:

- të identifikojnë elemente të veprës (tema, motive, personazhe, ngjarje);
- të dallojnë fakte, ide dhe mesazhe të shprehura në tekst;
- të shpjegojnë kuptimin e një fragmenti ose të një situate letrare;
- të përcaktojnë tipare të personazheve apo të mënyrës së rrëfimit.

Pyetje me përgjigje të hapur, të cilat kërkojnë nga nxënësit:

- të interpretojnë dhe vlerësojnë veprën ose elemente të saj;
- të argumentojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre mbi personazhe, ngjarje apo mesazhe;
- të lidhin veprën me kontekstin historik, shoqëror ose me përvoja dhe situata bashkëkohore;
- të shprehin reflektime personale të mbështetura në tekstin letrar.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i pyetjeve të rubrikës “Kartolina e librit” realizohet sipas rregullave të vlerësimit të pyetjeve në teste. Këto rregulla janë të njohura si për mësuesit, ashtu edhe për nxënësit. Pyetjet në këtë rubrikë janë të njëjtit nivel vështirësie për të gjitha skuadrat, me qëllim garantimin e barazisë dhe të objektivitetit në vlerësim. *Kjo rubrikë ka 14 pikë.*

Shembuj pyetjesh:

- Si do të ndryshonte mesazhi kryesor i veprës, nëse Nemeçeku nuk do të ishte kthyer te grupi pas sëmundjes? 2 pikë**

Model përgjigjeje:

Nëse Nemeçeku nuk do të ishte kthyer te grupi, mesazhi kryesor i veprës do të merrte një drejtim tjetër, pasi sakrifica, besnikëria dhe forca morale nuk do të

konkretizoheshin përmes veprimit të tij. Kthimi i Nemeçekut thekson se vlera e njeriut qëndron te karakteri, përgjegjësia dhe përkushtimi ndaj grupit, edhe kur kjo sjell pasoja personale.

Shpërndarja e pikëve:

- 1 pikë: përcakton se mungesa e kthimit të Nemeçekut do të sillte ndryshim në mesazhin kryesor të veprës;
- 1 pikë: argumenton këtë ndryshim, duke iu referuar qartë rolit të Nemeçekut dhe vlerave që ai përfaqëson në vepër (sakrificë, besnikëri, përgjegjësi ndaj grupit).

2. Cilin personazh do ta doje shok klase dhe pse?

2 pikë

Model përgjigjeje:

Do të doja Nemeçekun si shok klase, sepse është i ndershëm dhe besnik, edhe kur kjo i sjell vështirësi personale.

Shpërndarja e pikëve:

- 1 pikë: zgjedhja e personazhit
- 1 pikë: arsye e lidhur me tipare të personazhit

3. Çfarë na mëson libri për mënyrën si duhet të sillemi në një grup? Përmend dy rregulla që vlejné edhe sot në shkollë.

4 pikë

Model përgjigjeje:

Libri na mëson se në një grup duhet të respektojmë njëri-tjetrin dhe të mbajmë fjalën e dhënë. Një rregull që vlen edhe sot është të mos përjashtojmë askënd dhe të mbrojmë bashkëpunimin.

Shpërndarja e pikëve:

- 2 pikë: nxjerrja e vlerave nga vepra
- 2 pikë: lidhja me realitetin shkollor

4. Pse autori zgjedh këndvështrimin e një fëmije për të treguar ngjarjet e luftës? Çfarë i shton kjo rrëfimit?

3 pikë

Model përgjigjeje:

Këndvështrimi i fëmijës e bën rrëfimin më të sinqertë, duke treguar absurditetin e luftës pa përshkrime të drejtpërdrejta. Ai lejon që ngjarjet e rënda të shihen përmes pafajësisë dhe kureshtjes së një fëmije.

Shpërndarja e pikëve:

- 1 pikë: kuptimi i zgjedhjes së këndvështrimit nga autori
- 2 pikë: shpjegim i qartë dhe i lidhur me veprën

5. Si pasqyrohet lufta në jetën e përditshme të qytetit? Jepni dy shembuj nga romani. 4 pikë

Model përgjigjeje:

Lufta nuk shfaqet duke u përshkruar drejtpërdrejt betejat, por përmes frikës, thashethemeve dhe ndryshimit të sjelljes së njerëzve, si pritja e ushtrive të ndryshme dhe pasiguria e përditshme.

Shpërndarja e pikëve:

- 2 pikë: identifikimi i mënyrës së pasqyrimit
- 2 pikë: shembuj nga vepra

6. Çfarë e bën zërin e Anës të dëgjohet ende sot? Jepni të paktën tri argumente. 3 pikë

Model përgjigjeje:

Zëri i Ana Frankut dëgjohet ende sot sepse përvoja e saj personale shndërrohet në një mesazh universal që i kapërcen kufijtë e kohës dhe të historisë. Së pari, ajo trajton tema që mbeten aktuale edhe sot, si liria, dinjiteti njerëzor dhe shpresa përballë padrejtësisë. Së dyti, rrëfimi i saj i sinqertë e bën lexuesin të identifikohet me përjetimet e saj, pavarësisht epokës. Së treti, ditari i saj shërben si kujtesë historike dhe morale, duke paralajmëruar pasojat e urrejtjes dhe të mohimit të të drejtave njerëzore, çka e bën zërin e saj të vazhdojë të ketë kuptim edhe sot.

Shpërndarja e pikëve:

- 1 pikë për çdo argument

Kartolina e librit

Përshkrimet e mëposhtme janë hartuar në formën e kartolinave të librave me qëllim nxitjen e leximit dhe zgjerimin e interesit për librin edhe te nxënësit që nuk janë pjesë

e skuadrave të konkursit. Ato nuk synojnë të zëvendësojnë leximin e veprave, por synojnë të zgjojnë kureshtjen e nxënësve për të lexuar. Përmes një gjuhe të qartë dhe tërheqëse, këto përshkrime synojnë ta afrojnë librin me nxënësit dhe t'i motivojnë ata që të lexojnë.

Kartolinat e librave mund të prezantohen për dëgjuesit gjatë zhvillimit të konkursit.

“Historia e Skënderbeut” (1898)

Ky një libër është një rrëfim që e kthen të shkuarën në zë, figurë dhe emocion. Në 22 këngë epike, Naim Frashëri rindërton jetën e Skënderbeut nga fëmijëria deri në fund të jetës së tij, duke e shndërruar historinë në poezi dhe poezinë në thirrje për ndërgjegje kombëtare.

Skënderbeu në këtë vepër nuk është vetëm luftëtar i pamposhtur. Ai shfaqet si njeri që mendon, dyshon, merr vendime të vështira dhe mban mbi vete barrën e një kombi. Ai është udhëheqës që nuk lufton për lavdi personale, por për lirinë dhe dinjitetin e vendit të vet. Pikërisht kjo e bën figurën e tij të afërt edhe sot: sepse pas përkrenares dhe shpatës qëndron një njeri me përgjegjësi të madhe morale.

Poema të çon në betejë, në kuvende, në momente gëzimi dhe humbjeje. Gjuha është e pasur, e rrjedhshme dhe e lidhur fort me frymën popullore, duke e bërë leximin të gjallë dhe të fuqishëm. Çdo këngë të jep ndjesinë se po dëgjon një rrëfim që nuk është shkruar vetëm për t'u lexuar, por për t'u mbajtur mend.

Leximi i *Historisë së Skënderbeut* nuk është vetëm njohje me figurën më të rëndësishme historike të kombit, por një mënyrë për të kuptuar si u ndërtua ideja e atdheut në letërsinë shqipe. Është një libër që flet për trimërinë, sakrificën dhe dashurinë për vendin, por edhe për përgjegjësinë që çdo brez ka ndaj historisë së vet.

Pse duhet ta lexosh? Ky libër të mëson se historia nuk është vetëm ajo që ka ndodhur, por edhe mënyra se si e tregojmë dhe e mbajmë gjallë. Dhe sepse, ndonjëherë, një poemë mund të të bëjë të ndihesh më afër rrënjëve të tua se çdo tekst tjetër.

Djemtë e rrugës Pal” Ferenc Molnar (1907)

Ky libër të çon në botën e fëmijërisë, aty ku një shesh i vogël loje bëhet më i rëndësishëm se gjithçka tjetër. Dy grupe djemsh përplasen për ta mbrojtur atë që për ta është territor, krenari dhe identitet, por shumë shpejt kupton se kjo histori nuk ka të bëjë vetëm me lojën. Ajo flet për rregullat e pashkruara të miqësisë, për besnikërinë ndaj grupit dhe për peshën e fjalës së dhënë.

Në qendër të rrëfimit qëndron Nemeçeku, djali më i vogël dhe më i brishtë, i nënvlerësuar nga të tjerët, por që me veprimet e tij tregon se guximi nuk matet me forcë fizike. Ai nuk kërkon lavdi, nuk bën zhurmë, por zgjedh të qëndrojë besnik parimeve të veta, edhe kur kjo i kushton shëndetin dhe jetën. Pikërisht përmes tij, romani të bën të reflektosh se çfarë do të thotë të jesh i drejtë, i ndershëm dhe i përgjegjshëm.

Rrëfimi është i thjeshtë, i drejtpërdrejtë dhe shumë i afërt me botën e fëmijëve. Personazhet gabojnë, emocionohen, krenohen dhe frikësohen, ashtu si çdo fëmijë apo i ri. Konflikti nuk zgjidhet me fitore të lehtë, por me një pyetje të fortë që mbetet edhe pas mbylljes së librit: çfarë ka më shumë vlerë, fitorja apo dinjiteti?

Leximi i romanit *“Djemtë e rrugës Pal”* është një përvojë që të bën të mendosh për miqësinë, për shoqërinë dhe për vendimet që na përcaktojnë si njerëz. Është një libër që lexohet me emocion dhe që mbetet gjatë në kujtesë, sepse flet për gjëra të vogla në pamje të parë, por të rëndësishme për rritjen dhe formimin e karakterit.

“Princi i vogël” Antoine de Saint-Exupéry (1943)

Ky libër duket i thjeshtë, por fsheh pyetje që prekin thellë. *Princi i vogël* rrëfen udhëtimin e një fëmije nga një planet i vogël drejt botëve të ndryshme, ku takon personazhe të çuditshme që përfaqësojnë mënyra të ndryshme të menduarit dhe të jetuarit. Përmes këtij udhëtimi, lexuesi vendoset përballë një kontrasti të fortë mes botës së fëmijëve dhe botës së të rriturve. Me një gjuhë të qartë dhe dialogë të ngrohtë, libri flet për miqësinë, përgjegjësinë dhe aftësinë për të parë përtej asaj që duket. Princi i vogël na kujton se shumë gjëra të rëndësishme nuk shihen me sy, por ndihen me zemër dhe se lidhjet njerëzore kërkojnë kujdes, kohë dhe përkushtim. Çdo takim i tij është një pasqyrë e botës sonë dhe një ftesë për të reflektuar mbi vlerat që shpesh i harrojmë duke u rritur.

Ky është një libër që mund të lexohet në çdo moshë dhe që çdo herë zbulon diçka të re. Ai nuk jep mësim drejtpërdrejt, por të shtyn të mendosh, të ndalesh dhe të pyesësh veten se çfarë ka vërtet rëndësi në jetë. Pikërisht kjo e bën *Princin e vogël* një libër të veçantë: sepse flet me zë të qetë, por lë gjurmë të forta.

Pse duhet ta lexosh? Sepse të ndihmon të kuptosh se gjërat më të rëndësishme nuk janë gjithmonë ato që duken dhe se të menduarit me zemër është po aq i rëndësishëm sa të menduarit me mendje.

“Ditari i Ana Frankut” Anne Frank (1947)

Ky libër është zëri i singertë i një vajze adoleshente që shkruan për jetën e saj në një kohë kur liria i është mohuar. Përmes shënimeve të përditshme, Ana Frank na lejon të hyjmë në

botën e saj të brendshme, ku frika, shpresa, ëndrrat dhe pyetjet për jetën bashkëjetojnë në mënyrë të natyrshme. Rrëfimi i saj nuk është thjesht dëshmi historike, por një histori thellësisht njerëzore.

Në faqe të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, lexuesi ndjek rritjen mendore dhe shpirtërore të Anës, marrëdhëniet me familjen dhe përpjekjen për të kuptuar veten dhe botën përreth. Shkrimi bëhet për të një mënyrë për të reflektuar, për të ruajtur identitetin dhe për të mos humbur veten në kushte izolimi dhe pasigurie. Pikërisht kjo e bën librin kaq prekës: sepse flet për forcën e fjalës edhe kur gjithçka tjetër duket e pamundur.

Ditari tregon se si përvoja personale mund të shndërrohet në kujtesë kolektive. Ai na mëson se edhe në rrethana ekstreme, njeriu mbetet i aftë të mendojë, të ndiejë dhe të shpresojë. Ky është një libër që nuk kërkon vetëm të lexohet, por të kuptohet dhe të mbahet mend. Leximi i tij është një takim i drejtpërdrejtë me një zë të ri, të ndershëm dhe të guximshëm, që vazhdon të flasë edhe sot. Është një ftesë për të reflektuar mbi lirinë, dinjitetin dhe rëndësinë e dëgjimit të historive njerëzore.

Pse duhet ta lexosh? Sepse të kujton se fjala e shkruar mund të mbijetojë edhe në kohët më të vështira dhe se zëri i një adoleshenteje mund të bëhet zë i gjithë njerëzimit.

“Shpella e piratëve” Petro Marko (1964)

Ky roman të çon në brigjet e jugut shqiptar, aty ku deti fsheh histori dhe shpella ruan sekrete shekullore. Ngjarjet zhvillohen pranë Dhërmiut, në vendlindjen e autorit, duke i dhënë rrëfimit një ndjesi reale dhe të gjallë, sikur çdo faqe të mbajë erën e kripës dhe zhurmën e dallgëve.

Në qendër të librit është një grup fëmijësh që, të nxitur nga kureshtja dhe dëshira për zbulim, vendosin të eksplorojnë një shpellë misterioze buzë detit. Aventura e tyre nuk është e rastësishme: ajo kërkon përgatitje, guxim dhe bashkëpunim. Me ndihmën e peshkatarit Niko Dabo, fëmijët ndërtojnë një varkë dhe nisen drejt së panjohurës, duke u ndier njëkohësisht aventurierë, zbulues dhe arkeologë të vegjël.

Brenda shpellës, ata përballen me errësirën, frikën dhe rrezikun, por edhe me zbulime që lidhen me historinë e saj dhe me njerëzit që kanë jetuar aty dikur. Çdo hap brenda saj është një provë, por edhe një emocion i ri. Kur dalin, kuptojnë se varka nuk është më aty dhe aventura merr përmasa edhe më të mëdha. Zjarri që ndezin për ndihmë bëhet shenjë shprese dhe lidhjeje me botën jashtë.

Romani është ndarë në disa pjesë që e mbajnë gjallë ritmin dhe tensionin, duke e çuar lexuesin nga përgatitja, te përballja me rrezikun dhe deri te kthimi, jo thjesht i shpëtuar, por

i ndryshuar. Në fund, fëmijët largohen nga shpella me krenarinë se ishin të parët që guxuan të hynin në të, dhe me shpresën se një ditë do të kthehen sërish.

Shpella e piratëve është më shumë se një histori aventurë. Është një libër për kureshtjen, guximin, miqësinë dhe dëshirën për të zbuluar botën. Ai të kujton se rritja vjen pikërisht në momentet kur guxon të hysh në të panjohurën.

Pse duhet ta lexosh? Sepse të bën të ndihesh pjesë e një aventurë të vërtetë, të mëson të besosh te bashkëpunimi dhe të kujton se zbulimet më të mëdha fillojnë nga një pyetje e thjeshtë: *po sikur të shkojmë atje?*

“Tregime të moçme shqiptare” Mitrush Kuteli (1965)

Ky libër të çon në një botë ku fjala e rrëfyer ka peshë, ku legjenda, përralla dhe kujtesa popullore ndërthuren me artin e shkrimit. Mitrush Kuteli merr tregimet e vjetra shqiptare dhe i rishkruan me një gjuhë të pasur dhe plot ngjyra, duke u dhënë atyre jetë të re. Lexuesi ndjen se po dëgjon një rrëfim të lashtë, të treguar pranë oxhakut, por me forcën e një veprë letrare të menduar me kujdes.

Personazhet e këtyre prozave përballen me sprovë, zgjedhje të vështira dhe pasoja që shpesh i tejkalojnë. Në to gjen mençuri popullore, drejtësi, besë, por edhe dobësi njerëzore. Fantastikja bashkëjeton me realen dhe çdo histori bart një kuptim që flet për jetën, njeriun dhe shoqërinë, pa qenë nevoja për shpjegime të drejtpërdrejta.

Leximi i *Tregimeve të moçme shqiptare* është një mënyrë për t’u lidhur me rrënjët dhe me mënyrën se si brezat e mëparshëm kanë kuptuar botën. Gjuha e Kutelit është një përvojë më vete: e pasur, e rrjedhshme dhe e ngarkuar me ndjeshmëri, që e bën çdo tregim të këndshëm dhe domethënës.

Ky libër nuk lexohet me nxitim. Ai kërkon të shijohet, të ndalesh te fjalët dhe te atmosfera që krijojnë. Ai është një ftesë për të zbuluar bukurinë e tregimit shqiptar dhe për të kuptuar se letërsia tradicionale mund të jetë po aq e fuqishme sa çdo rrëfim modern.

Pse duhet ta lexosh? Sepse në këto tregime gjen zërin e së shkuarës shqiptare, të treguar me mjeshtëri letrare dhe sepse ato të ndihmojnë të kuptosh më mirë botën shqiptare.

“Kronikë në gur” Ismail Kadare (1971)

Ky roman të fton të hysh në jetën e një qyteti të vogël shqiptar, aty ku historia e madhe kalon nëpër rrugica, shtëpi, thashetheme dhe biseda të përditshme. Ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore rrëfehen jo nga heronj apo kronika zyrtare, por përmes syve të një fëmije që vëzhgon, dëgjon dhe përpiket të kuptojë botën e të rriturve. Pikërisht ky këndvështrim e bën librin të veçantë dhe të afërt.

Qyteti shfaqet si një personazh më vete: me frikërat, thashethemet, ironinë dhe përpjekjen për të mbijetuar mes pushtimesh të njëpasnjëshme. Rrëfimi është i thjeshtë në dukje, por i mbushur me kuptime, ku humori i hollë dhe pafajësia fëmijërore ndërthuren me tensionin dhe pasigurinë e luftës. Kadare arrin të tregojë dramën pa e rënduar, duke e lënë lexuesin të zbulojë vetë peshën e ngjarjeve.

Kronikë në gur nuk është vetëm një roman për luftën, por një libër për kujtesën, për mënyrën se si njerëzit e zakonshëm e përjetojnë historinë dhe si ajo mbetet e gdhendur në mendje, ashtu si në gur. Lexuesi ndien se po hyn në një botë reale dhe njëkohësisht poetike, ku çdo detaj i vogël ka rëndësi.

Ky libër të mëson se historia nuk jeton vetëm në data dhe beteja, por edhe në përditshmërinë e njerëzve, në frikën e tyre, në heshtjet dhe në mënyrën si e tregojnë atë që u ka ndodhur. Është një lexim që të afron me letërsinë shqiptare dhe me mënyrën e saj unike për të rrëfyer. *Pse duhet ta lexosh?* Sepse të tregon se si një histori e madhe mund të rrëfëhet me zë të qetë, përmes syve të një fëmije dhe të mbetet po aq e fortë dhe e paharrueshme.

2. Pyetje shpejtësie (Kuiz)

Kuizet janë një formë e veçantë e vlerësimit ose e testimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve. Ato kanë një rëndësi të veçantë për arsye se e bëjnë konkursin më tërheqës dhe më emocionues; u japin mundësi nxënësve të testojnë njohuritë e tyre në mënyrë të strukturuar dhe argëtuese; zhvillojnë te nxënësit aftësi të ndryshme si të kuptuarit, analiza, vlerësimi, zgjidhja e problemeve etj.; ndikojnë në nxitjen e konkurrencës së shëndetshme mes nxënësve.

Në konkurs, kuizi ka 20 pikë, nga të cilat 10 pikë janë për njohuritë gjuhësore dhe 10 pikë për njohuritë letrare.

Gjatë konkursit, pyetjet e shpejtësisë (kuiz) mund të ndahen në dy pjesë, me nga 10 pikë. Në kuiz ka pyetje të mbyllura ose objektive (që kanë vetëm një përgjigje të saktë):

- me përgjigje të shkurtër;
- me *Po/Jo* ose *E vërtetë/ E gabuar*;
- me plotësim.

P.sh.:

- Cila është ngjarja e rëndësishme në të cilën u bë unifikimi i alfabetit të gjuhës shqipe?

- Cili duhet konsideruar si i vërtetë në një informacion që lexojmë: *fakti apo opinioni?*
- Figura letrare e përdorur në vargun: *“Po vjen si pëllumb i shkruar”*, është_____.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një shembull kuizi:

NR.	Pyetje	Përgjigje
1.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Gjuha shqipe është pjesë e familjes së gjuhëve indo-evropiane.	E saktë
2.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Çështja kryesore e Kongresit të Manastirit ishte njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe.	E saktë
3.	Si quhet tërësia e krijimeve artistike të një populli, e cila trashëgohet brez pas brezi?	Folklor
4.	<i>Poezia epike zakonisht nuk ndjek një linjë tregimtare, por është një shprehje emocionesh në vargje, ku mbizotërojnë figurat letrare.</i> <i>E saktë apo e gabuar?</i>	E gabuar
5.	Në cilin rast mbiemri është përdorur në mënyrë të figurshme: <i>re e bardhë</i> APO <i>zemër e bardhë</i> ?	<i>Zemër e bardhë</i>
6.	Nisur nga prania e gjymtyrëve kryesore, përcaktoni llojin e fjalisë: <i>“Guri i rëndë në vend të vet!”</i>	Fjali njëkryegjymtyrëshe emërore
7.	Ç’ figurë letrare është përdorur në fjalinë: <i>“Tingujt e muzikës ua shkrinë zemrat”</i> ?	Metaforë
8.	Cili është dokumenti i parë i shqipes së shkruar?	Formula e Pagëzimit
9.	Cila nga fjalët e gjuhës shqipe zëvendëson fjalën <i>“insistoj”</i> ?	Këmbëngul
10.	Plotësojeni fjalën e urtë: <i>“Punën e sotme mos e lër ...”</i>	Për nesër
11.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Dokumentarët, kronikat, reportazhet janë tekste për media.	E saktë
12.	Kthejeni krahasimin në metaforë: <i>“Vajza ishte si lule pranvere.”</i>	Vajza ishte lule pranvere

13.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Në ligjëratën e drejtë, riprodhimi i fjalëve nga folësi shprehet me disa ndryshime.	E gabuar
14.	Cili është lloji më i gjatë i teksteve në prozë?	Romani
15.	Cili është lloji i formimit të fjalës “Trembëdhjetë”?	Përngjitja
16.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Rima e përputhur është ABAB.	E gabuar
17.	<i>E saktë apo e gabuar?</i> Një poezi lirike dallon për mesazhin e fortë që përcjell përmes ngjarjes.	E gabuar
18.	Ç’ lloj kallëzuesi ka në fjalinë “Bora nisi të lexonte romanin”?	Kallëzues të përbërë
19.	A janë personazhe të “Ciklit të Kreshnikëve” Ajkuna dhe Tanusha?	Po
20.	Në fjalinë “Mos rri pranë zjarrit, sepse do të digjesh.”, fjala “pranë” është ndajfolje apo parafjalë?	Parafjalë

Në këtë rubrikë, përgjigjet skuadra që ngre dorën e para ose shtyp butonin më shpejt. Skuadra fiton një pikë për çdo përgjigje të saktë.

Disa rregulla bazë për nxënësit gjatë kuizit (pyetjeve të shpejtësisë) janë:

- Dëgjoni me kujdes çdo pyetje për të kuptuar saktësisht çfarë kërkohet dhe prisni derisa të përfundojë pyetja përpara se të përgjigjeni.
- Nëse keni dyshime, diskutoni shkurtimisht me shokët e skuadrës dhe më pas vendosni për përgjigjen tuaj.
- Jepni një përgjigje të qartë dhe të saktë, duke iu përmbajtur kërkesës së pyetjes.
- Kur përgjigjeni, flisni qartë që të dëgjoheni dhe të kuptoheni nga të gjithë.
- Respektioni kohën e përgjigjes. Për çdo pyetje, ka një kohë të caktuar për të dhënë përgjigjen. Nëse nuk përgjigjeni brenda kësaj kohe, pyetja i kalon skuadrës tjetër.
- Mos u shqetësoni nëse gaboni! Përpikuni të jepni përgjigje të sakta për pyetjet e tjera.

3. Recitimi

Recitimi është një formë e interpretimit artistik të një teksti, gjatë të cilit nxënësit nuk kufizohen vetëm të riprodhimi mekanik, por përpiqen të përcjellin emocionet, mesazhet dhe atmosferën e tekstit përmes intonacionit, gjesteve dhe përdorimit të duhur të zërit. Nëpërmjet recitimit, teksti “merr jetë”, pasi nxënësi bëhet ndërmjetës mes autorit/ tekstit dhe dëgjuesit, duke i dhënë interpretimit një ngjyrim personal dhe krijues. Recitimi është një nga rubrikat e konkursit, pasi:

- ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë tekstet letrare përmes interpretimit të tyre emocional dhe artistik.
- zhvillon aftësinë për të komunikuar qartë dhe me ndjenjë para dëgjuesve.
- zhvillon imagjinatën dhe të menduarit krijues, duke i inkurajuar nxënësit të realizojnë një interpretim personal të tekstit;
- përmirëson shqiptimin, intonacionin dhe përdorimin e gjuhës shqipe në mënyrë korrekte;
- rrit vetëbesimin dhe aftësinë për të folur në publik, duke i ndihmuar nxënësit të ndihen të sigurt gjatë paraqitjeve të tyre;
- krijon një lidhje më të fortë me gjuhën amtare dhe zhvillon aftësinë për të vlerësuar artin e fjalës së shkruar.

Në konkurs, recitimi do të jetë maksimumi **2.5 minuta** (*dy minuta e gjysmë*). Teksti që do të recitohet mund të jetë prozë, poezi, prozë poetike ose tekst dramatik.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një listë sugjeruese nga mund të shkëputen tekstet/ fragmentet për recitim. Gjatë konkursit nxënësit mund të përzgjedhin edhe tekste ose fragmente të tjera, me kusht që të jenë nga autorë përfaqësues të letërsisë shqipe.

PROZA	POEZI
- Përralla popullore shqiptare - Mitrush Kuteli, prozë - Faik Konica, prozë poetike - Koliqi, prozë - Petro Marko, prozë - Ismail Kadare, prozë	- Epika dhe lirika shqiptare (poezi popullore) - Naim Frashëri “Lulet e verës” - Çajupi “Baba Tomorri” - Serembe, poezi - Ndre Mjeda, poezi - Gjergj Fishta “Mrizi i zanave” poezi

- Migjeni, proza të shkurtra - Bedri Dedja, prozë - Zija Çela, prozë	- Fan Noli "Album" - Migjeni "Vargje të lira" - Lasgush Poradeci "Vallja e yjeve" - Filip Shiroka "Shko dallëndyshe" - Ismail Kadare, poezi - Ali Asllani, poezi - Dritëro Agolli, poezi - Ali Podrimja, poezi - Fatos Arapi, poezi - Xhevahir Spahiu, poezi - Din Mehmeti, poezi - Azem Shkreli, poezi - Visar Zhiti, poezi - Teodor Keko, poezi
POEMA	DRAMA
- Pjesë nga Cikli i Kreshnikëve - Naim Frashëri "Bagëti e bujqësi" - Jeronim de Rada "Këngët e Milosaos" - Ndre Mjedja "Andrra e jetës" - Mitrush Kuteli "Poemi kosovar" - Ismail Kadare "Princesha Argjiro" dhe "Kronikë në gur"	- Çajupi "Pas vdekjes" ose "14 vjeç dhëndër" - Santori "Emira" - Fan Noli "Izraelitë e filistinë" - Kostandin Kristoforidhi "Gjahu i malësorëve" - Sami Frashëri "Besa" - Ekrem Kryeziu "Epoka para gjyqit" - Fadil Kraja "Gjaku i Arbrit"

Kriteret e vlerësimit të recitimit

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë kriteret që juria e konkursit, në të gjitha fazat, do të përdorë për vlerësimin e recitimeve të nxënësve. Rezultati përfundimtar do të jetë shuma e pikëve për të gjitha kriteret. Maksimumi i pikëve është **8 (tetë)**.

Kriteret/ Pikët	0	1	2 ¹
Kuptimi dhe interpretimi	Nxënësi: - nuk demonstroi kuptim të tekstit,	Nxënësi: - demonstroi kuptim të pjesshëm të	Nxënësi: - përzgjedh për recitim një tekst nga një

¹ 0- Dobët, 1- Mirë, 2- Shumë mirë

	ideve dhe mesazhit. - reciton mekanikisht, pa shprehje emocionesh. - nuk përdor intonacion të përshtatshëm për të përcjellë atmosferën e tekstit.	tekstit dhe të ideve kryesore. - përpiket të shprehë emocionet e tekstit, por në mënyrë jo të qëndrueshme. - përdor intonacion dhe përcjell mirë mesazhin dhe atmosferën e tekstit.	shkrimtar përfaqësues i letërsisë shqipe, duke u përqendruar në vlerat estetike dhe artistike që ai ofron përmes bukurisë së gjuhës dhe stilit të veçantë. - demonstroi të kuptuarit e tekstit, të ideve dhe të mesazhit të tij. - shpreh emocionet dhe ndjenjat që përcjell teksti përmes gjuhës së trupit dhe shprehjeve të fytyrës. - përdor intonacionin për të përcjellë mesazhin dhe atmosferën e tekstit.
<i>Shqiptimi dhe saktësia</i>	Nxënësi: - bën gabime në shqiptim, që ndikojnë në kuptimin e tekstit. - nuk kontrollon zërin dhe volumin është i papërshtatshëm për dëgjuesit.	Nxënësi: - shqipton fjalët saktë, por bën pak gabime që herë pas here ndikojnë në qartësinë e recitimit. - kontrollon pjesërisht zërin, por volumi nuk është gjithmonë i qëndrueshëm.	Nxënësi: - shqipton saktë fjalët dhe fjalitë, duke shmangur gabimet e shqiptimit që mund të ndikojnë në kuptimin e tekstit gjatë recitimit. - kontrollon zërin dhe përdor volumin e duhur, në mënyrë që të dëgjohet qartë.
<i>Shpejtësia dhe ritmi</i>	Nxënësi: - reciton me shpejtësi të papërshtatshme (shumë shpejt ose shumë ngadalë), duke	Nxënësi: - reciton përgjithësisht me shpejtësi të pranueshme, por me luhatje në ritëm.	Nxënësi: - reciton me shpejtësinë e duhur për të lehtësuar të kuptuarit e tekstit nga dëgjuesit.

	vështirësuar kuptimin. - nuk përdor pauza ose ritmi nuk përputhet me tekstin.	- përdor pauza jo gjithmonë të qëllimshme.	- përshtat shpejtësinë dhe ritmin e recitimit me atmosferën dhe me tonin e tekstit. - përdor pushimet ose pauzat për të theksuar momentet kyç të tekstit.
<i>Siguria dhe kontakti me dëgjuesit</i>	Nxënësi: - shfaq pasiguri gjatë recitimit (ngurrim, hezitim, shmangie e kontaktit vizual). - nuk krijon lidhje me dëgjuesit.	Nxënësi: - demonstroi siguri të pjesshme, por shfaq herë pas here shenja pasigurie. - krijon kontakt vizual të kufizuar me dëgjuesit.	Nxënësi: - demonstroi siguri gjatë recitimit, pa shenja pasigurie ose ngurrimi. - krijon një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të natyrshme me dëgjuesit përmes kontaktit vizual dhe angazhimit emocional.

Disa rregulla bazë për nxënësit në lidhje me recitimin janë:

- ✓ Përzgjidhni një tekst nga një shkrimtar përfaqësues i letërsisë shqipe, duke u përqendruar në vlerat estetike dhe artistike që ai ofron përmes bukurisë së gjuhës dhe stilit të veçantë.
- ✓ Para se të filloni recitimin, sigurohuni që i keni kuptuar plotësisht idetë, mesazhin dhe ndjenjat që shprehen në tekst. Sigurohuni që të kuptoni edhe kontekstin historik dhe kulturor të tekstit, pasi ky informacion do t'ju ndihmojë ta transmetoni atë në mënyrën e duhur.
- ✓ Gjatë recitimit, kontrolloni që zëri juaj të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për dëgjuesit. Përdorni volumnin e duhur dhe shmangni recitimin shumë të shpejtë ose shumë të ngadaltë. Përshtatni shpejtësinë e recitimit për të siguruar që mesazhi të kuptohet qartë.
- ✓ Ndryshoni shpejtësinë dhe përdorni pauza për të theksuar momentet kyç dhe për të pasqyruar emocionet që përmban teksti. Përdorni intonacionin dhe shprehjen e fytyrës për të pasqyruar ndjenjat dhe emocionet që shprehen në tekst.

- ✓ Komunikoni me sy me të pranishmit. Ky komunikim do t'i bëjë ata të ndihen të përfshirë dhe të lidhur me recitimin tuaj, duke e rritur ndikimin e recitimit.
- ✓ Praktikoni recitimin para konkursit për të përmirësuar sigurinë dhe natyrshmërinë tuaj. Sa më shumë të praktikoni, aq më mirë do të arrini të përshtatni ritmin, intonacionin dhe shprehjet e trupit për një recitim të suksesshëm.

4. Debat i në konkurs

Debat i është një formë diskutimi e strukturuar, përmes të cilit nxënësit trajtojnë një temë ose çështje të caktuar duke paraqitur qëndrime të argumentuara. Kjo rubrikë synon zhvillimin e aftësive për formulimin e ideve, ndërtimin e argumenteve dhe paraqitjen e tyre në mënyrë të qartë dhe koherente në një kontekst publik.

Përfshirja e debatit në konkurs u krijon nxënësve mundësi për të analizuar dhe për të vlerësuar problematika të ndryshme, për të mbështetur qëndrimet e tyre me fakte dhe shembuj të besueshëm, si dhe për të respektuar rregullat e komunikimit etik dhe bashkëbisedimit. Nëpërmjet kësaj rubrike, nxitet mendimi kritik, dëgjimi aktiv dhe reagimi i argumentuar ndaj qëndrimeve të kundërta, duke kontribuar në formimin e qytetarisë aktive dhe në përdorimin e përgjegjshëm të gjuhës shqipe.

Pjesëmarrja në debat i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi bashkëpunimi, dëgjimi aktiv dhe respektimi të pikëpamjeve të ndryshme. Përmes dialogut të strukturuar, nxënësit angazhohen në shkëmbim idesh, analizojnë qëndrime të ndryshme dhe ndërtojnë argumente të mbështetura në arsyetime dhe fakte.

Debat i përgatit nxënësit për përballimin e situatave sfiduese, duke rritur sigurinë në shprehjen dhe mbrojtjen e qëndrimeve të tyre në mënyrë të qartë dhe efektive. Angazhimi i vazhdueshëm në diskutime të argumentuara kontribuon në forcimin e vetëbesimit, si dhe në zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe të menduarit kritik.

Organizimi i kësaj rubrike në konkurs:

Në konkurs do të jepet një temë e caktuar, mbi të cilën nxënësit do të paraqesin mendimet, qëndrimet dhe këndvështrimet e tyre. Pozicionimi i skuadrave *pro* ose *kundër* temës përcaktohet **me short**, përpara fillimit të debatit.

Debat i zhvillohet në mënyrë të strukturuar, duke u dhënë mundësi anëtarëve të skuadrës të kontribuojnë me ide, argumente dhe shembuj përkatës, në përputhje me

pozicionin e përcaktuar. Debati përfundon me një përmbledhje përmbyllëse, e cila realizohet nga një nxënës i skuadrës, ku sintetizohen pikat kryesore të trajtuara dhe qëndrimi përfundimtar i grupit.

Kohëzgjatja e debatit është **deri në 10 minuta** dhe duhet të respektohet në mënyrë rigoroze nga të gjitha skuadrat pjesëmarrëse.

Tematikat dhe disa shembuj temash për debatin:

Fushat tematike të debateve (si edhe në rastin e projekteve) në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe janë:

- Ruajtja dhe promovimi i pasurisë së gjuhës shqipe
- Komunikimi në rrjetet sociale
- Bullizmi verbal dhe gjuha e urrejtjes online
- Gjithëpërfshirja
- Ndotja e mjedisit
- Marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve
- Media dhe informacioni
- Qytetaria dhe roli i nxënësve në komunitet
- Etika dhe rregullat e komunikimit

Shembuj temash për debatet:

1. A është detyrë e çdo nxënësi të marrë pjesë në iniciativa për përmirësimin e jetës së shkollës?
2. A duhet të ketë moshë minimale (p.sh., 14 vjeç) për hapjen e llogarive në rrjetet sociale?
3. A duhet të ndalohet përdorimi i plastikës me një përdorim në shkollë?
4. A duhet të zëvendësohen fletoret me tableta digjitale?
5. A është edukimi apo ndalimi mënyra më e mirë për të parandaluar gjuhën e urrejtjes?
6. A duhet që shkolla të ndërhyjë edhe kur bullizmi verbal ndodh jashtë mjedisit shkollor?
7. A është i drejtë përdorimi i inteligjencës artificiale (si ChatGPT) për detyrat e shkollës?

8. A duhet të zëvendësohen provimet përfundimtare me projekte dhe vlerësim të vazhdueshëm gjatë vitit?
9. A duhet të vazhdojë mësimi online edhe pas përfundimit të pandemisë?
10. A janë miqësitë virtuale po aq të vlefshme sa ato në jetën reale?

Kriteret e vlerësimit të debatit

Kjo është rubrika që juria e konkursit do të përdorë për vlerësimin e debatit. Rezultati përfundimtar do të jetë shuma e pikëve për secilin kriter. Maksimumi i pikëve është **15 (pesëmbëdhjetë)**.

Shkalla e vlerësimit

- 0 pikë - Dobët
- 1 pikë - Mjaftueshëm
- 2 pikë - Mirë
- 3 pikë - Shumë mirë

Kriteret / Pikët	0	1	2	3
Njohuritë rreth temës dhe parashtrimi i argumenteve (Për shkak të rëndësisë, ky kriter vlerësohet me 0-dobët; 2-mjaftueshëm; 4-mirë; 6- shumë mirë)	Nxënësit tregojnë njohuri shumë të kufizuara rreth temës së debatit dhe nuk arrijnë të paraqesin argumente të qarta ose të qëndrueshme.	Nxënësit tregojnë njohuri të pjesshme rreth temës së debatit dhe paraqesin argumente të pakta dhe jo të mirëstrukturuara.	Nxënësit tregojnë njohuri të mira rreth temës dhe paraqesin argumente të qarta, por jo gjithmonë të forta ose të qëndrueshme.	- Nxënësit tregojnë njohuri të mira rreth temës së debatit. - Nxënësit prezantojnë argumente të forta dhe të qëndrueshme në mbështetje të pikëpamjes së tyre.
Kreativiteti dhe origjinaliteti	Nxënësit nuk shfaqin origjinalitet dhe përsërisin ide të zakonshme,	Nxënësit shfaqin origjinalitet të kufizuar dhe përdorin pak shembuj ose analogji, të cilat	Nxënësit janë përgjithësisht origjinalë dhe përdorin shembuj ose analogji që	- Nxënësit janë origjinalë në prezantimin e mendimeve dhe të

	pa përdorur shembuj ose zgjidhje të reja.	nuk e pasurojnë ndjeshëm këndvështrimin.	ndihmojnë pjesërisht në paraqitjen e një këndvështrimi personal.	argumenteve të tyre. - Nxënësit përdorin shembuj ose analogji që ndihmojnë në shfaqjen e një këndvështrimi origjinal për një çështje. - Nxënësit propozojnë zgjidhje të reja për një çështje të caktuar.
Gjuha dhe komunikimi	Nxënësit shprehin ide dhe argumente në mënyrë jo fort të qartë, me fjalor të kufizuar dhe me vështirësi në kontrollin e zërit dhe të emocioneve.	Nxënësit shprehin ide të kuptueshme, por jo gjithmonë bindëse; përdorin fjalor të thjeshtë dhe intonacion jo të qëndrueshëm.	Nxënësit shprehin ide dhe argumente qartë dhe në mënyrë bindëse, përdorin fjalor të përshtatshëm dhe kontrollojnë përgjithësisht intonacionin dhe gjuhën e trupit.	- Nxënësit shprehin ide dhe argumente në mënyrë të qartë, bindëse dhe të besueshme. - Nxënësit kanë fjalor të pasur dhe përdorin intonacionin e duhur. - Nxënësit përdorin në mënyrën e duhur gjuhën e trupit dhe shprehjet e fytyrës. - Nxënësit flasin qetë dhe kontrollojnë emocionet.

Respektimi i rregullave dhe bashkëpunimi	Nxënësit nuk zbatojnë rregullat e debatit dhe nuk tregojnë respekt për mendimet e të tjerëve.	Nxënësit zbatojnë pjesërisht rregullat dhe shfaqin vështirësi në pranimin e mendimit ndryshe.	Nxënësit zbatojnë rregullat e debatit dhe bashkëpunojnë me skuadrën, duke treguar respekt për mendimin ndryshe.	- Nxënësit zbatojnë rregullat gjatë debatit. - Nxënësit shfaqin respekt dhe vlerësim të pikëpamjeve të të tjerëve në skuadër. - Nxënësit pranojnë mendimin ndryshe.
---	---	---	---	---

Disa rregulla bazë për nxënësit në lidhje me debatin janë:

- Nxënësit respektojnë pikëpamjet dhe mendimet e anëtarëve të skuadrës dhe të kundërshtarëve, duke dëgjuar me vëmendje dhe pa ndërprerje.
- Gjatë debatit përdoret një gjuhë e respektueshme dhe një ton i qetë; kontrolli i emocioneve është i detyrueshëm.
- Debati zhvillohet duke iu përmbajtur temës ose çështjes së dhënë; shmangia nga tema nuk lejohet.
- Të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të kenë mundësi të barabartë për të shprehur qëndrimet e tyre; dominimi i debatit nga një ose dy nxënës nuk lejohet.
- Çdo nxënës respekton kohën e përcaktuar për ndërhyrje dhe nuk e tejkalon kufirin kohor të caktuar.
- Çdo qëndrim i paraqitur gjatë debatit duhet të mbështetet me argumente të qarta, fakte ose shembuj të besueshëm; qëndrimet e pabazuara nuk vlerësohen.
- Gjatë debatit flet vetëm nxënësi që ka radhën e fjalës; ndërprerjet dhe komentet jashtë radhe nuk lejohen.
- Debati përfundon me një përmbledhje përmbyllëse, e cila realizohet nga një nxënës i skuadrës.
- Mosrespektimi i rregullave të debatit ndikon negativisht në vlerësim.

5. Lojërat gjuhësore

Lojërat gjuhësore shërbejnë si momente argëtimi dhe motivimi për të përforcuar njohuritë. Studimet tregojnë se ndërveprimi përmes lojërave rrit përvetësimin e fjalorit dhe nxit të menduarit krijues; gjithashtu, krijon një mjedis pozitiv duke rritur motivimin dhe ulur ankthin e konkurrimit. Kur nxënësit përballen me sfida argëtuese, ata janë më të prirur të angazhohen, të testojnë fjalorin, të mësojnë fjalë të reja dhe të shprehin aftësi krijuese duke analizuar e argumentuar në mënyrë kritike. Lojërat nxitin një rivalitet të shëndetshëm, duke i motivuar nxënësit të japin përgjigje të sakta dhe të marrin pjesë aktive.

Disa shembuj lojërash janë:

- *Loja e gjesteve*: Një nxënës përshkruan me gjeeste një shprehje frazeologjike ose fjalë të urtë; skuadra duhet ta gjejë.
- *Tregimi me radhë*: Përdoren disa fjalë kyç për të krijuar një tregim të përbashkët, duke vlerësuar krijimtarinë dhe përdorimin e gjuhës.
- *Gara e drejtshkrimit*: Një garë drejtshkrimore me fjalë që zakonisht shkruhen gabim.
- *Lojë kujtese me sinonime*: Kërkohen çifte sinonimesh ose antonimesh në një tabelë.
- *Fjala misterioze*: Skuadrat bëjnë pyetje “po/jo” për të zbuluar fjalën misterioze në kohë të kufizuar.
- *Dueli i shprehjeve frazeologjike*: Skuadrat sfidohen në njohjen dhe interpretimin e shprehjeve frazeologjike.
- *Sfida e reklamës*: Çdo ekip krijon një reklamë të shkurtër për një fjalë apo shprehje, duke përdorur humor dhe krijimtari.
- *Fusha leksikore*: Jepet një temë dhe skuadrat duhet të listojnë fjalët që lidhen me të brenda një minute.

Pikëzimi dhe rregullat e lojërave gjuhësore

Kjo rubrikë vlerësohet me **13 pikë** në total. Çdo lojë ka rregullat e veta, me të cilat nxënësit njihen paraprakisht. Çdo përgjigje e saktë vlerësohet nga juria me një pikë. Kjo mënyrë vlerësimi inkurajon shpejtësinë dhe saktësinë, duke e bërë garën dinamike dhe motivuese.

6. Projekti

Projekti është një strategji të nxëni me në qendër nxënësin. Ai nxit ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe lëndore. Ndryshe nga orët mësimore standarde në klasë, projektet janë më gjithëpërfshirëse, duke i lejuar nxënësit të bëjnë kërkime, të mendojnë në mënyrë kritike, të angazhohen në veprimtari praktike në të cilat eksplorojnë, të zbatojnë në mënyrë krijuese njohuritë e tyre dhe të zgjidhin probleme të klasës, shkollës dhe komunitetit të tyre.

TIK duhet të përdoret pothuajse gjatë çdo ore mësimore, por sidomos gjatë zhvillimit të projekteve kurrikulare është i domosdoshëm.

Në arsimin parauniversitar, projekti kurrikular është një komponent i domosdoshëm në çdo lëndë mësimore dhe për këtë arsye është edhe një nga rubrikat e konkursit.

Projekti në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe

- Gjatë të gjitha fazave të konkursit, çdo skuadër/ shkollë dorëzon dy materiale:
 - a) projektin e shkruar
 - b) prezantimin e projektit në format PPT
- Të dyja materialet duhet të jenë të përgatitura dhe të dorëzuara sipas afateve të përcaktuara nga organizatorët.
- Elemente të produktit të projektit si fletë-palosje, prototipe, material pamore apo objekte të tjera mbështetëse mund të paraqiten gjatë prezantimit, por nuk zëvendësojnë dorëzimin e projektit të shkruar dhe të prezantimit.
- Çdo shkollë/ skuadër është e detyruar të dorëzojë projektin e shkruar dhe prezantimin e projektit në format PPT përpara konkurrimit në çdo fazë të konkursit. Dorëzimi paraprak i këtyre materialeve ka për qëllim njohjen e jurisë me përmbajtjen, strukturën dhe cilësinë e projektit, si dhe garantimin e një vlerësimi të drejtë, të barabartë dhe të paanshëm për të gjitha skuadrat pjesëmarrëse.
- Datat dhe afatet e dorëzimit të projektit të shkruar dhe të prezantimit në PPT njoftohen përkatësisht nga shkolla, ZVAP-të, DRAP-et, AKAP dhe ASCAP, sipas fazës së konkursit.

Struktura e projektit

Projekti i shkruar duhet të jetë i strukturuar qartë dhe të përfshijë elementet e mëposhtme:

- *Shkolla*: Shënohet emri i shkollës
- *Tema e projektit*: Përcaktohet tema kryesore që trajton projekti.
- *Qëllimi i projektit*: Përshkruhet pse realizohet projekti dhe çfarë synon në tërësi.
- *Rezultatet e pritshme*: Përcaktohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet/vlerat që pritet të zhvillohen tek nxënësit gjatë realizimit të projektit.
- *Partnerët/ bashkëpunëtorët*: Shënohen partnerët që përfshihen në projekt, si individë ose institucione që kontribuojnë në realizimin e tij.
- *Veprimtaritë kryesore*: Përshkruhen aktivitetet dhe hapat kryesorë që ndërmerren gjatë realizimit të projektit, duke përfshirë planifikimin, kërkimin, përpunimin e informacionit dhe prezantimin përfundimtar.
- *Burimet kryesore të informacionit*: Përcaktohen burimet që nxënësit përdorin për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, nën udhëzimin e mësuesit.
- *Përshkrimi i produktit të projektit*: Përshkruhet lloji i produktit final që do të realizohet në përfundim të projektit dhe mënyra se si ai do të prezantohet.

Udhëzime të përgjithshme për shkrimin e projektit

Dokumenti i projektit të shkruar duhet të plotësojë këto kërkesa teknike:

- Fonti: Times New Roman
- Madhësia e shkronjave: 12
- Hapësira ndërmjet rreshtave: 1.5
- Teksti: i justifikuar
- Margjinat: standarde (2.5 cm në të gjitha anët)
- Numërim faqesh

Dokumenti i projektit të shkruar duhet të jetë i disponueshëm në çdo fazë të prezantimit të projektit.

Material orientues: Për t'u orientuar për shkrimin e projekteve, shkollat dhe mësuesit mund të bazohen në udhëzuesin "*Zhvillimi i kompetencave përmes projekteve*", i hartuar nga ASCAP. Ky material ofron udhëzime për hartimin dhe vlerësimin e projekteve, si dhe shembuj projektesh. Linku është: [Manual-projektet-gjuhe-dhe-letersi.pdf](#)

Struktura e prezantimit të projektit

- *Hyrja*: Prezantoni shkurt temën e projektit, shkollën dhe grupin e punës.
- *Qëllimi i projektit*: Përshkruani qartë qëllimin kryesor të projektit dhe atë që synon të arrijë përmes produktit të krijuar.
- *Veprimtaritë kryesore të projektit*: Paraqitni shkurt hapat dhe veprimtaritë kryesore që janë zhvilluar për realizimin e projektit.
- *Produkti i projektit*: Prezantoni produktin e krijuar si rezultat të veprimtarive të zhvilluara. Shpjegoni funksionet kryesore të tij, përdorimin praktik dhe mënyrën se si zgjidh problemin e identifikuar. Përdorni shembuj konkretë, demonstrime ose ilustrime të produktit.
- *Rezultatet dhe përfitimet*: Përmendni shkurt rezultatet kryesore dhe përfitimet që sjell produkti për nxënësit, shkollën ose komunitetin.
- *Mbyllja*: Falënderim për vëmendjen. Përgjigje ndaj pyetjeve të jurisë.

Udhëzime të përgjithshme për shkrimin e prezantimit të projektit

- Prezantimi duhet të jetë i përmbledhur dhe i qartë, me fokus te produkti i projektit.
- Prezantimi realizohet në 5-7 slide gjithsej.
- Slide i parë duhet të përmbajë:
 - ✓ titullin e projektit,
 - ✓ emrin e shkollës,
 - ✓ logon e shkollës (nëse ka),
 - ✓ emrat e anëtarëve të grupit.
- Çdo slide duhet të paraqesë vetëm një ide kryesore, me tekst të shkurtër dhe elemente pamore.
- Veprimtaritë dhe procesi përmenden shkurt, vetëm sa për të kuptuar si është arritur produkti.
- Theksi vihet te produkti, përdorimi i tij dhe përfitimet që sjell.
- Shmangen tekstet e gjata, përshkrimet teorike dhe përsëritjet.
- Slide i fundit përdoret për përmbyllje dhe falënderim.

Shembuj temash për projekte

Fushat tematike të projekteve në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe janë:

- Ruajtja dhe promovimin i pasurisë së gjuhës shqipe
- Komunikimi në rrjetet sociale
- Bullizmi verbal dhe gjuha e urrejtjes online
- Gjithëpërfshirja
- Ndotja e mjedisit
- Marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve
- Media dhe informacioni
- Qytetaria dhe roli i nxënësve në komunitet
- Etika dhe rregullat e komunikimit

Më poshtë janë dhënë disa shembuj temash, të cilat janë dhënë vetëm për t'u orientuar. Shkollat vendosin vetë për temën e projektit dhe në konkurs, për këtë rubrikë vlerësohet më shumë ideja interesante, risitë dhe lidhja e projektit me jetën reale të nxënësve dhe të komunitetit përreth tyre.

- *"Shqipja ime në rrjetet sociale"*: Nxënësit prodhojnë një seri videosh të shkurtra, ku shpjegojnë rregulla drejtshkrimore dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe. Videot publikohen në faqen e shkollës ose në një platformë të lejuar (p.sh. YouTube), duke krijuar një bibliotekë digjitale edukative.
- *"Dialektet shqiptare: një pasuri që s'duhet humbur"*: Shkolla realizon një dokumentar 5-7 minutash, duke intervistuar familjarë e komunitetin për fjalë dialektore. Dokumentari shfaqet në shkollë dhe ruhet online si arkiv multimedial.
- *"Gjuha shqipe dhe etika në komentet online"*: Nxënësit analizojnë shembuj komentesh në platformat e lejuara, dhe krijojnë një udhëzues digjital për komunikim të respektueshëm, i publikuar si broshurë interaktive ose si faqe web.
- *"Fjalët që po humbasim"*: Projekti përfshin grumbullimin e fjalëve të vjetra shqipe dhe përgatitjen e një fjalori digjital (site ose aplikacion) ku çdo fjalë ka përkufizim, shembull dhe regjistrim audio.
- *"Shkolla për të gjithë"*: Hartohet një udhëzues mbi gjithëpërfshirjen në arsim, me shembuj konkretë dhe këshilla, i shpërndarë tek nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

- *“Zëri i natyrës”*: Nxënësit krijojnë një revistë digjitale mujore rreth mbrojtjes së mjedisit, me ese, artikuj, fotografi dhe intervista lokale, të publikuara në një blog ose format “flipbook”.
- *“Zëri i komunitetit tonë”*: Grupi ndërton një platformë mediatike digjitale (blog, kanal YouTube, podcast), ku publikon reportazhe dhe intervista për problematika reale të komunitetit dhe sugjeron zgjidhje.
- *“Stop bullizmit - Fuqia e zërit tonë”*: Një fushatë multimediale ku nxënësit prodhojnë video edukative, postera digjitale dhe sondazhe online për të ndërgjegjësuar bashkëmoshatarët ndaj bullizmit.
- *“Mbrojtja e mjedisit në komunitetin tonë”*: Projekt ku nxënësit organizojnë një fushatë digjitale ndërgjegjësimi; prodhojnë video të shkurtra, postime informuese dhe nxisin veprime konkrete (p.sh. mbledhje mbeturinash) në bashkëpunim me komunitetin.
- *“Rrugë pa dhunë”*: Krijimi i një mini-serie videosh apo podcastesh ku nxënësit trajtojnë dhunën verbale/fizike, tregojnë histori reale dhe prezantojnë mënyra për ta parandaluar.
- *“Asistenti digjital për gjuhën shqipe”*: Krijimi i një asistenti të thjeshtë digjital që u përgjigjet pyetjeve bazë në gjuhën shqipe dhe ndihmon nxënësit të praktikojnë rregulla gramatikore. Produkti shoqërohet me një udhëzues digjital përdorimi.
- *“Loja digjitale e fjalorit shqip”*: Ndërtimi i një loje ndërvepruese (kuiz online ose aplikacion i thjeshtë) që ndihmon nxënësit të mësojnë dhe të përforcojnë fjalor dhe rregulla gramatikore. Produkti final është një lojë funksionale, e përdorshme në orë mësimi ose në faqen e shkollës.

Kriteret e vlerësimit të prezantimit të projektit

Kjo është rubrika që juria e konkursit do të përdorë për vlerësimin e projektit. Rezultati përfundimtar do të jetë shuma e pikëve për të gjitha kriteret. Maksimumi i pikëve është **30 (pikë)**.

Kriteret / Pikët	Dobët 0 pikë	Mjaftueshëm 1-2 pikë	Mirë 3- 4 pikë	Shumë mirë 5-6 pikë
Lidhja me jetën reale dhe risitë	Projekti nuk ka lidhje me jetën	Projekti identifikon një	Projekti trajton qartë një	Projekti është thellësisht i lidhur

<i>Trajtimi i një situate ose problematike reale, me ide ose zgjidhje origjinale.</i>	reale dhe nuk sjell risi. Ai trajton një temë të përgjithshme pa lidhje të qartë me realitetin.	problematikë reale, por e trajton në mënyrë të përgjithshme. Idetë e reja janë të pakta.	situatë/ problematikë reale dhe ofron ide origjinale.	me jetën reale dhe sjell një perspektivë/ zgjidhje të re, të argumentuar mbi problematikën, duke prezantuar ide origjinale.
Hulumtimi dhe analiza <i>Cilësia e kërkimit, burimet e përdorura, mënyra e analizës dhe përpunimi i informacionit.</i>	Projekti nuk ka hulumtim të dokumentuar; përdor burime jo të besueshme dhe nuk kryen analizë të të dhënave.	Projekti përfshin disa burime, por analiza është e kufizuar dhe citimet janë të paplota.	Projekti shfrytëzon burime të besueshme; mbledh dhe analizon të dhënat në mënyrë të strukturuar; citimet janë të sakta.	Projekti kryen hulumtim të gjerë me burime të shumta e të besueshme dhe analizon në detaje të dhënat, duke i sintetizuar në mënyrë kritike me citime të plota.
Përdorimi i gjuhës shqipe në projekt <i>Saktësia dhe pasuria e gjuhës, struktura e tekstit dhe drejtshkrimi.</i>	Teksti ka gabime drejtshkrimore dhe gramatikore; fjalori është i varfër dhe struktura është e paqartë.	Gjuha ka disa gabime; fjalori dhe ndërtimi i fjalive janë të thjeshta; struktura e projektit është e qartë.	Përdoret gjuhë e saktë dhe e pasur; projekti është i organizuar mirë me pak gabime.	Teksti është rrjedhshëm, i pasur dhe i saktë; nuk ka gabime; struktura dhe argumentet janë shumë të mirëorganizuar dhe bindëse.
Kreativiteti dhe qëndrueshmëria <i>Qasja krijuese në konceptim dhe paraqitje, si dhe vlerësimi i zbatueshmërisë dhe i ndikimit afatgjatë të projektit.</i>	Projekti nuk paraqet ide origjinale dhe nuk merr parasysh qëndrueshmërinë. prezantimi është konvencional.	Projekti tregon disa elemente krijuese, por qasja nuk është e qartë; trajtimi i qëndrueshmërisë është sipërfaqësor.	Projekti paraqet ide të veçanta dhe një prezantim krijues; merr në konsideratë zbatueshmërinë dhe ndikimin në afat të gjatë.	Projekti ofron ide origjinale dhe të guximshme; prezantimi është shumë kreativ; qëndrueshmëria është integruar plotësisht në zgjidhje, duke treguar ndërgjegjësim të qartë për

				ndikimin afatgjatë.
Bashkëpunimi, prezantimi dhe përdorimi i TIK-ut <i>Puna në ekip, cilësia e prezantimit dhe mënyra e integritetit të teknologjisë në projekt.</i>	Skuadra nuk bashkëpunon dhe disa anëtarë nuk kontribuojnë; prezantimi është i paqartë; teknologjia përdoret pak.	Skuadra bashkëpunon pjesërisht; prezantimi është i kuptueshëm, por nuk është i strukturuar; teknologjia përdoret vetëm në disa pjesë të projektit.	Skuadra punon bashkë dhe detyrat ndahen; prezantimi është i qartë dhe i organizuar; teknologjia përdoret për hulumtim dhe për paraqitjen e rezultateve.	Skuadra bashkëpunon në mënyrë të shkëlqyer; prezantimi është profesional dhe bindës; teknologjia integrohet në çdo fazë të projektit dhe e bën paraqitjen tërheqëse dhe efikase.

Disa rregulla bazë për nxënësit në lidhje me prezantimin e projektit janë:

- Përgatiteni në ppt prezantimin e projektit, duke respektuar madhësinë e shkronjave, numrin e fjalëve në një slajd, përdorimin e imazheve ose të grafikëve, formatimin e slajdeve dhe redaktimin gjuhësor të prezantimit.
- Sigurohuni që projekti dhe përmbajtja e prezantimit të jenë të qartë dhe të strukturuar në mënyrë të kuptueshme për dëgjuesit.
- Prezantimi duhet të ketë një fillim, zhvillim dhe fund të qartë, duke përfshirë një hyrje të projektit, një përshkrim të metodologjisë së përdorur dhe rezultatet e arritura.
- Respektoni kohën e përcaktuar (*deri në 5 minuta*) për prezantimin dhe sigurohuni që të mos tejkalohet ajo.
- Përdorni elemente pamore (*imazhe, grafikë, fotografi nga projekti*), të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e kuptueshmërisë dhe të tërheqjes së vëmendjes së dëgjuesve.
- Shfaqni siguri gjatë prezantimit të projektit dhe përgjigjuni pyetjeve të jurisë në fund të prezantimit. Gjatë prezantimit mund të përfshihen të gjithë anëtarët e skuadrës ose mund të prezantohet nga një prej tyre.

- Praktikohuni për prezantimin para një numri të vogël dëgjuesish, para prezantimit të vërtetë për të qenë sa më të përgatitur dhe të sigurt.

Roli i mësuesit/ve në projektin e shkollës

Mësuesi/t që drejtori i shkollës ka caktuar për përgatitjen e skuadrës së shkollës në konkurs, kanë përgjegjësinë për mbështetjen dhe orientimin e skuadrës së shkollës gjatë procesit të hartimit dhe të prezantimit të projektit.

Mësuesi/it kanë për detyrë:

- ✓ të udhëzojnë nxënësit në përzgjedhjen dhe qartësimin e temës së projektit, që ai të sjellë risi dhe të zgjidhë probleme për nxënësit, shkollën ose për komunitetin;
- ✓ të asistojnë në planifikimin e punës dhe në strukturimin e përmbajtjes së projektit;
- ✓ të garantojnë përdorimin korrekt, etik dhe të dokumentuar të burimeve dhe të TIK-ut;
- ✓ të mbështesin nxënësit në shkrimin e projektit sipas formatit të dhënë në këtë rubrikë të konkursit;
- ✓ të përgatisin nxënësit për prezantimin dhe argumentimin e projektit, pa ndërhyrë në përmbajtjen krijuese dhe në formulimin e ideve të tyre.

Veanërisht në fazën e tretë të konkursit, mësuesi/it kanë detyrim të veçantë të mbështesin skuadrën përfaqësuese të shkollës në përgatitjen përfundimtare të projektit dhe në ushtrimin e prezantimit të tij, duke garantuar përputhjen me kriteret e vlerësimit të kësaj rubrike.

Procesi i përgatitjes dhe i zhvillimit të projektit monitorohet edhe nga specialisti i ZVAP-së, përgjegjës për organizimin e konkursit në nivel shkolle dhe ZVAP, me qëllim paraqitjen në konkurs me projekte cilësore.

ÇMIMET NË KONKURSIN KOMBËTAR TË GJUHËS SHQIPE

Në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe parashikohet ndarja e çmimeve me qëllim vlerësimin e arritjeve të nxënësve, si në nivel skuadre, ashtu edhe për performanca të veçanta cilësore. Çmimet jepen në përputhje me qëllimet dhe objektivat e konkursit. Në çdo fazë të konkursit ndahen çmime për të evidentuar interpretimin, aftësitë argumentuese dhe qasjen novatore të nxënësve, si dhe shpalljen e shkollave fituese sipas renditjes përfundimtare të skuadrave.

Llojet e çmimeve

Çmimet për skuadrat fituese

Në çdo fazë të konkursit, shpallen skuadrat fituese bazuar në pikët e grumbulluara sipas rubrikave të vlerësimit të përcaktuara në udhëzues.

Çmime të veçanta

Në çdo fazë të konkursit, juria ndan edhe çmime të veçanta për të vlerësuar aspekte specifike të performancës së nxënësve, si p.sh.:

- *Interpretimi më i bukur*: Jepet për nxënësin e talentuar në rubrikën e recitimit.
- *Debatuesit më të mirë*: Jepet për skuadrën që ka ndërtuar argumente të qarta dhe koherente, ka përdorur shembuj bindës, ka respektuar etikën e debatit dhe ka demonstruar aftësi të të menduarit kritik dhe të të folurit në publik.
- *Projekti më novator*: Jepet për projektin që dallohet për ide origjinale, qasje bashkëkohore dhe realizimin e një produkti konkret, të zbatueshëm dhe të dobishëm për shkollën ose komunitetin, duke reflektuar përdorim cilësor të gjuhës shqipe.

SKUADRAT E SHKOLLAVE DHE RREGULLAT E KONKURSIT

1. Përbërja e skuadrave të shkollave në konkurs

Në konkurs, çdo shkollë do të përfaqësohet nga një skuadër e përbërë prej 5 nxënësish dhe 1 nxënës rezervoë.

Mësuesit e gjuhës shqipe, gjatë përzgjedhjes së nxënësve, duhet të marrin në konsideratë aftësitë dhe prirjet e tyre. Skuadra duhet të përfshijë nxënës të talentuar në lëndën e gjuhës shqipe, me aftësi të spikatura:

- në krijimtarinë dhe shprehjen artistike;
- në recitimin dhe interpretimin e teksteve;
- në të folurit para publikut dhe parashtrimin e argumenteve;
- në mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve;
- në zbatimin e njohurive gramatikore dhe drejtshkrimore në mënyrë të saktë.

Përzgjedhja e nxënësve duhet të bazohet në diversitetin e aftësive dhe potencialin e tyre për të kontribuar në suksesin e skuadrës gjatë konkursit.

Shënim:

Në përbërjen e skuadrës në konkurs përfshihet një nxënës rezervë, përzgjedhja e të cilit duhet të shihet si një detyrë e rëndësishme për suksesin e shkollës. Nxënësi rezervë është gjithnjë i gatshëm të zëvendësojë ndonjë prej pjesëtarëve të skuadrës në rast se ky i fundit nuk mund të marrë pjesë për arsye të ndryshme.

Gjatë konkursit, nxënësi rezervë mbështet skuadrën me inkurajim dhe vëzhgim aktiv, duke kontribuar në ruajtjen e frymës së bashkëpunimit. Ai punon krahas bashkëmoshatarëve të tij, duke u përgatitur për çdo detyrë që mund t'i kërkohet gjatë konkursit.

Gjatë konkursit, ai mund të mbajë shënime për rezultatet e skuadrës dhe të konkurrentëve, duke ndihmuar në reflektimin pas përfundimit të aktivitetit. Me këtë qasje, nxënësi do ta ndiejë se është pjesë aktive e skuadrës dhe do ta përjetojë me motivim dhe përgjegjësi angazhimin e tij në konkurs.

2. Rregullat kryesore për nxënësit në konkurs

Për të siguruar një mbarëvajtje të suksesshme të konkursit, është e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit të respektojnë rregullat e mëposhtme.

- Ndani detyrat brenda skuadrës për secilën nga rubrikat e konkursit dhe caktoni përgjegjësitë.
- Përgatituni për konkursin dhe bashkëpunoni me mësuesin e gjuhës shqipe dhe me nxënësit e tjerë.

- Diskutoni dhe zgjidhni së bashku strategjinë më të mirë për realizimin e secilës detyrë.
- Respektoni rregullat dhe formatin e sugjeruar për rubrikat e konkursit që kërkojnë punë paraprake, si p.sh., prezantimi i projektit.
- Paraqituni në kohën e duhur në konkurs.
- Respektoni etikën në veshje dhe në komunikim.
- Respektoni dhe vlerësoni pikëpamjet e të tjerëve gjatë konkursit.
- Përdorni rregullat e komunikimit korrekt dhe të etikës gjatë bashkëbisedimeve dhe diskutimeve.
- Jepni kontributin tuaj gjatë punës përgatitore dhe gjatë zhvillimit të konkursit.
- Bashkëpunoni me nxënësit e tjerë të skuadrës gjatë zhvillimit të konkursit, duke i ndihmuar dhe duke mbështetur njëri-tjetrin.
- Pranoni dhe respektoni vendimet e jurisë dhe rregullat e konkursit.

3. Rregullat kryesore në lidhje me lëvizjen e nxënësve gjatë konkurrimit në nivel kombëtar

- Para udhëtimit të nxënësve për regjistrimin e episodit të konkursit, për të respektuar kuadrin ligjor në fuqi, mësuesi kujdestar në bashkëpunim me mësuesin e gjuhës shqipe dhe me drejtorinë e shkollës, duhet të sigurojë miratimin ose lejen me shkrim të prindit/kujdestarit (*Shtojca 2*).
- Nxënësit e skuadrës së shkollës shoqërohen nga 1-2 mësues, ku njëri mund të jetë edhe specialist i ZVAP-së.
- Mësuesit shoqërues janë përgjegjës për plotësimin e listës emërore të pjesëmarrësve, sipas modelit të dhënë (*Shtojca 3*).
- Nxënësit dhe mësuesit informohen paraprakisht mbi:
 - ✓ Agjendën e ditës së xhirimeve.
 - ✓ Rregullat që duhen respektuar gjatë xhirit të konkursit.
- Nxënësit duhet të mbërrijnë në orarin e përcaktuar dhe të ndjekin udhëzimet e organizatorëve gjatë gjithë ditës.
- Shkolla, në bashkëpunim me prindërit dhe mësuesit shoqërues, duhet të sigurojë një transport të sigurt dhe të organizuar për nxënësit.

ROLI I SHKOLLAVE

1. Roli i drejtorive të shkollave

Roli i drejtorive të shkollave është thelbësor për organizimin e konkursit.

Organizimi dhe garantimi i fazës në nivel shkolle

- Siguron zhvillimin e konkursit mes klasave të nënta në shkollë (ose brenda klasës, kur ka vetëm 1 klasë të nëntë), me synim identifikimin e nxënësve që do të përfaqësojnë shkollën në fazat e tjera.
- Ngrihet juria në nivel shkolle me urdhër të drejtorit (juria mund të përbëhet nga mësues të gjuhës shqipe dhe, sipas mundësive, edhe drejtues, mësues gjuhësh të huaja, ish-mësues gjuhe, prindër/profesione të lidhura me gjuhën e letërsinë).
- Krijon kushte për proces të rregullt e të drejtë (hapësirë, mjedis, qetësi, rregulla organizimi), pra drejtësi dhe transparencë në zhvillim.

Caktimi i mësuesve përgjegjës dhe mbështetja e skuadrës së shkollës

- Cakton një ose më shumë mësues (kryesisht të gjuhës shqipe) që ngarkohen me përgatitjen e skuadrës përfaqësuese për fazat pasuese.
- Siguron që mësuesit të mbështesin nxënësit në përgatitjen e rubrikave (sidomos projekti, debati dhe rubrikat e tjera), pa e zëvendësuar punën e nxënësve.

Koordinimi i komunikimit dhe afateve

- Njofton dhe koordinon brenda shkollës organizimin, datat, oraret, rregullat dhe kërkesat e konkursit (një “timeline” i qartë).
- Për rubrikën Projekti, drejtorja ndihmon në zbatimin e kërkesës që projekti i shkruar dhe prezantimi PPT të dorëzohen brenda afateve që komunikohen sipas fazës (shkollë/ZVAP/DRAP/AKAP/ASCAP).

Bashkëpunimi me monitorimin institucional

- Lehtëson dhe garanton monitorimin e fazës në nivel shkolle nga ZVAP, siç parashikohet në udhëzues, për të siguruar zbatimin korrekt të rregullave dhe procedurave.

Përzgjedhja e skuadrës (si proces) dhe përfaqësimi i shkollës

- Ndërsa mësuesi/ët e gjuhës shqipe përzgjedhin nxënësit mbi bazën e talentit dhe rezultateve, drejtorja:

- ✓ siguron që procesi të jetë i dokumentuar dhe i rregullt (p.sh. procesverbal i jurisë, sipas shtojcave);
- ✓ mbështet përzgjedhjen që merr parasysh rubrikat e konkursit (nxënës që spikat në recitim/interpretim, krijimtari, projekt, debat, etj.), që skuadra të jetë funksionale.

Siguria dhe përgjegjësitë praktike të pjesëmarrjes

- Në kuadër të lëvizjes/pjesëmarrjes në fazat më tej, drejtoria bashkërendon brenda shkollës elementët praktikë që lidhen:
 - ✓ me dokumentacionin (p.sh. miratimi i prindit/kujdestarit, lista emërore për transport - sipas shtojcave të udhëzuesit);
 - ✓ organizimin e brendshëm që nxënësit të jenë gati për përfaqësim.

2. Roli i mësuesit/mësuesve të gjuhës shqipe

Mësuesit:

- Zbatojnë kërkesat e këtij udhëzuesi, duke ndërtuar dhe organizuar punën e tyre për përgatitjen e nxënësve për pjesëmarrje në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe.
- Përzgjedhin nxënësit përbërës të skuadrës së shkollës, duke marrë në konsideratë aftësitë, prirjet dhe talentet e tyre, si: aftësitë në të shkruar, në të folurit publik dhe recitim, si edhe njohuritë dhe zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore.
- Përgatisin nxënësit/skuadrën e shkollës për të gjitha fazat e konkursit, në përputhje me rubrikat e detyrueshme dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzues.
- Mbështesin dhe monitorojnë procesin e përgatitjes së projektit, duke orientuar nxënësit në mënyrë këshilluese dhe pa ndërhyrë në përmbajtjen krijuese të punës së tyre.
- Bashkëpunojnë me mësuesit kujdestarë dhe me drejtuesit e shkollës për sigurimin e miratimit/lejes së prindit ose kujdestarit ligjor për pjesëmarrjen e nxënësve në konkurs.
- Shoqërojnë dhe mbështesin nxënësit gjatë zhvillimit të konkursit në fazat në nivel ZVAP-je dhe në nivel kombëtar, duke garantuar respektimin e rregullave dhe mbarëvajtjen e procesit.

ROLI I DRAP- VE DHE I ZVAP-VE

Rolet dhe përgjegjësitë e mëposhtme janë bazuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit nr. 570, datë 07.11.2025, *“Për organizimin e konkursit kombëtar të gjuhës shqipe me nxënësit e klasave të nënta në arsimin parauniversitar, për vitin shkollor 2025–2026”*.

DRAP

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) ka rol kyç në koordinimin, monitorimin dhe garantimin e zhvillimit të rregullt të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe në nivel rajonal. Në këtë kuadër, DRAP-i:

- Monitoron organizimin dhe zhvillimin e konkursit në nivel shkolle dhe në nivel ZVAP-je, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt të rregullave, procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzues.
- Përcakton një përfaqësues në jurinë e konkursit në nivel ZVAP-je, për të siguruar një vlerësim të unifikuar, objektiv dhe transparent të skuadrave pjesëmarrëse.
- Rendit skuadrat fituese të ZVAP-ve që janë nën juridiksionin e tij, bazuar në pikët e grumbulluara sipas rubrikave të konkursit dhe kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në udhëzues.
- Përzgjedh katër (4) skuadrat fituese në nivel DRAP-i, të cilat kualifikohen për pjesëmarrje në fazën kombëtare të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe, në përputhje me procedurat e përcaktuara.
- Organizon dhe mbikëqyr procesin e vlerësimit shtesë të projektit, në rastet e barazimit të pikëve, duke ngritur jurinë përkatëse dhe duke garantuar respektimin e kriterëve të vlerësimit të kësaj rubrike.
- Bashkëpunon me AKAP-in për çështje që lidhen me organizimin dhe lëvizjen e nxënësve gjatë fazës kombëtare të konkursit.
- Siguron dokumentimin dhe raportimin e procesit, në përputhje me kërkesat institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.

ZVAP

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) ka rol të rëndësishëm në organizimin, koordinimin dhe monitorimin e Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe në nivel vendor. Në këtë kuadër, ZVAP:

- Monitoron fazën e konkursit në nivel shkolle, duke garantuar zbatimin korrekt të procedurave, rregullave dhe kriterëve të vlerësimit.
- Organizon fazën e konkursit në nivel ZVAP-je, duke përcaktuar vendin, datën, orarin dhe kushtet e zhvillimit të saj.
- Ngre juria e konkursit, sipas përcaktimeve të udhëzuesit, dhe sigurohet mbarëvajtja e procesit të vlerësimit të skuadrave pjesëmarrëse.
- Përpilon renditjen e skuadrave pjesëmarrëse në nivel ZVAP-i, bazuar në pikët e grumbulluara sipas rubrikave dhe kriterëve të vlerësimit.
- Përcjell rezultatet zyrtare të konkursit pranë DRAP-it përkatës, brenda afateve të përcaktuara.
- Bashkëpunon me drejtuesit e institucioneve arsimore dhe me mësuesit përgjegjës, për garantimin e pjesëmarrjes së rregullt të nxënësve dhe për zgjidhjen e çështjeve organizative.
- Siguron dokumentimin e procesit, në përputhje me kërkesat institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PROCESVERBAL I JURISË

Për vlerësimin shtesë të rubrikës së projektit

Sot, më datë _____, u mbledh juria për vlerësimin shtesë të rubrikës së projektit në kuadër të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe, në nivel DRAP-i, e përbërë nga:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Juria vlerësoi sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzuesin e konkursit, projektet e skuadrave me numrin maksimal të pikëve totale. Vlerësimi u krye individualisht nga çdo anëtar i jurisë dhe pikët përfundimtare u përlllogaritën si mesatare aritmetike.

Në përfundim, renditja e projekteve është si më poshtë:

Vendimi i jurisë është përfundimtar.

Anëtarët e jurisë (emri, mbiemri dhe firma):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

SHTOJCA 2: MIRATIMI I PRINDIT/KUJDESTARIT

Miratimi i prindit/kujdestarit është në përputhje me ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Unë, _____ prindi/kujdestari i nxënësit _____,
jam dakord me pjesëmarrjen e fëmijës tim në Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe,
i cili do të xhirohet në RTSH.

Firma e prindit/kujdestarit

Data: _____

SHTOJCA 3: LISTA EMËRORE E NXËNËSVE PËR TRANSPORT

Lista emërore e nxënësve për transport

Destinacioni: Nga _____ në _____

Personi/at përgjegjës _____ / _____

Nr.	Emri dhe mbiemri	Shkolla	Celular i nxënësit (nëse ka)	Celular i prindit/ kujdestarit
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				

BIBLIOGRAFIA

- Bell, S. (2010). Project-based learning for the 21st century: Skills for the future. *The Clearing House: A Journal of Educational Strategies, Issues and Ideas*, 83(2), 39–43.
<https://doi.org/10.1080/00098650903505415>
- Black, P., & Wiliam, D. (1998). Assessment and classroom learning. *Assessment in Education*, 5(1), 7–74. <https://doi.org/10.1080/0969595980050102>
- Brookhart, S. M. (2013). *How to create and use rubrics for formative assessment and grading*. ASCD.
- Council of Europe. (2018). *Reference framework of competences for democratic culture*. Council of Europe Publishing.
- De Grez, L., Valcke, M., & Roozen, I. (2009). The impact of an innovative instructional intervention on speech anxiety and speaking skills. *Journal of Communication Education*, 58(1), 29–44.
<https://doi.org/10.1080/03634520802569510>
- Fisher, A., & Scriven, M. (1997). *Critical thinking: Its definition and assessment*. Edgepress.
- Freeley, A. J., & Steinberg, D. L. (2014). *Argumentation and debate: Critical thinking for reasoned decision making* (13th ed.). Cengage Learning.
- Goh, C. C. M., & Burns, A. (2012). *Teaching speaking: A holistic approach*. Cambridge University Press.
- Kuhn, D. (1999). A developmental model of critical thinking. *Educational Researcher*, 28(2), 16–25. <https://doi.org/10.3102/0013189X028002016>
- Larmer, J., Mergendoller, J. R., & Boss, S. (2015). *Setting the standard for project based learning*. ASCD.
- Lucas, S. E. (2020). *The art of public speaking* (13th ed.). McGraw-Hill Education.
- McConachie, B. (2008). *Engaging audiences: A cognitive approach to spectatorship*. Palgrave Macmillan.
- OECD. (2018). *The future of education and skills: Education 2030*. OECD Publishing.
- OECD. (2019). *OECD future of education and skills 2030: Conceptual learning framework*. OECD Publishing.

- Rosenblatt, L. M. (1994). *The reader, the text, the poem: The transactional theory of the literary work*. Southern Illinois University Press.
- Schechner, R. (2013). *Performance studies: An introduction* (3rd ed.). Routledge.
- Thomas, J. W. (2000). *A review of research on project-based learning*. Autodesk Foundation.
- Toulmin, S. (2003). *The uses of argument* (Updated ed.). Cambridge University Press.
- UNESCO. (2015). *Rethinking education: Towards a global common good?* UNESCO Publishing.
- Wiggins, G. (1998). *Educative assessment: Designing assessments to inform and improve student performance*. Jossey-Bass.
- Wolf, M. (2007). *Proust and the squid: The story and science of the reading brain*. HarperCollins.